

Dr. Musli Vërbani

**SHKURT DHE QARTË**  
**II**

Kaçanik, 2026

Titulli:

**Shkurt dhe qartë II**

Autor:

**Dr. Musli Vërbani**

Korrektues:

**Burim Bunjaku**

Përgatitja kompjuterike:

**Ridvan Vërbani**

Dobia themelore e bisedave në mes njerëzve. Qoftë në jetën publike, qoftë edhe në jetën private, qoftë në jetën e përditshme, njësoj edhe nëpër rrjete sociale. Zoti i Madhërishtëm thotë:

**“S’ka dobi në shumë prej bisedave të tyre (të njerëzve) të fshehta, përveç:**

- kush urdhëron për lëmoshëdhënie**
- ose për veprimin e një vepre të mirë**
- ose në përmirësimin (pajtimin) e raporteve ndërmjet njerëzve.”**

**KAPITULLI I PARË:**  
**PERLA URTËSIE**

## **NUK KA VLERË**

Leximi me të pa kuptuar nuk ka vlerë.

Lëmosha e cila nuk mbahet fshehtë nuk ka vlerë.

Jeta pa ibadet nuk ka vlerë.

Shoqëria pa drejtësi nuk ka vlerë.

Fjala e palogjikshme nuk ka vlerë.

Bashkëveprimi pa respekt nuk ka vlerë.

Dashuria pa sinqeritet nuk ka vlerë.

Premtimi pa zbatim nuk ka vlerë.

Fëmija pa edukatë nuk ka vlerë.

Njeriu pa logjikë nuk ka vlerë.

## **EDUKATA E KUVENDIT**

Mos vallëzo mbi plagën e të tjerëve.

Mos u kreno me punën tënde para të papunësuarit.

Mos trego për pasurinë tënde para të varfrit.

Mos fol për aftësinë tënde para të paaftit.

Mos fol për lirinë tënde para të burgosurit.

Mos fol për fëmijët e tu para atij i cili nuk ka fëmijë.

Mos fol për prindërit para jetimit.

Mos shto plagë me injorancën tënde, por ndjenjat e të tjerëve bëji pjesë të personalitetit tënd.

## **RREGULLA EDUKATIVE**

Te dijetarët qëndro me mendjen tënde.

Te udhëheqësit qëndro me diturinë tënde.

Te shokët qëndro me edukatën tënde.

Te mendjehetët qëndro me urtësinë tënde.

Te anëtarët e familjes qëndro me butësinë tënde.

Para Zotit qëndro duke e përmendur Atë.

Në vetmi qëndro me këshillat e tua për veten tënde.

Në bazë të vendit, kuvendi!

## **TEPRIMI**

Teprimi në butësi është: dobësi.

Teprimi në qeshje është: mendjelehtësi.

Teprimi në qetësi është: amulli.

Teprimi në mosdhënie është: koprraci.

Teprimi në shpenzim pasurie është: shkapërderdhje.

Teprimi në përkujdesje është: vesvese.

Teprimi në mrrolje është: vrazhdësi.

Teprimi në arrogancë është: egërsi.

Teprimi në heshtje është: hidhërim.

## **SHOQËRIMI**

- Nëse shoqërohesh me të lumturin, do të kesh lumturi.

- Nëse shoqërohesh me harrestarin, harron.

- Nëse shoqërohesh me ata të cilët e përmendin Allahun, edhe ti do ta përmendësh Allahun.

- Nëse shoqërohesh me gjumashët, bëhesh gjumash.

- Nëse shoqërohesh me ata të cilët i kanë zemrat e vdekura ndaj fesë, zemra jote do të jetë e vdekur ndaj fesë.

Zoti i Madhërisëm i ka thënë Merjemës: **“Falu me ata të cilët falen”**.

## **SHOQËRIMI**

kush shoqërohet me dijetarë i forcohet morali;  
kush shoqërohet me gra i shtohet lakmia;  
kush shoqërohet me të pasur i egërsohet zemra;  
kush shoqërohet me fëmijë i forcohet kryelartësia;  
kush shoqërohet me mëkatarë i shtohet e keqja;  
kush shoqërohet me të mirët i shtohet devotshmëria;  
kush shoqërohet me fukahatë i rritet vlera.

Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Njeriu është në fenë e shokut të tij, andaj le të kujdeset se me kë shoqërohet”.*

## **BISEDA**

- Edukatë: të dish atë që e flet.
- Moral: të dëgjosh atë i cili flet.
- Sjellje e mirë: të mos e ndërpresësh fjalën e atij i cili flet.
- Urtësi: të jesh i vëmendshëm se çka flet.
- Mendjemprehtësi: të mos besosh gjithçka që flitet.

## **URTËSI**

- Nëse nuk mund t'u bësh dobi, së paku mos dëmto;
- Nëse nuk mund t'i gëzosh të tjerët, së paku mos i pikëllo;
- Nëse nuk mund të qëndrosh me të tjerët, së paku mos ofendo;
- Nëse nuk mund t'u gëzohesh sukseseve të të tjerëve, së paku mos i xhelozo;
- Nëse nuk mund t'i falënderosh të tjerët, së paku mos mallko.

## **RREGULLA EDUKATIVE**

Rri afër me atë i cili është i ngjashëm me ty.

Komuniko me atë i cili të nderon.

Konsultohu me atë i cili të do.

## **CILËSI E BESIMTARIT**

Besimtari:

- Bashkohet (me njerëz) për të mësuar.
- Hesht për t'u siguruar.
- Flet për t'u kuptuar.
- Vetmohon për të përfituar.

## **QETËSIA**

Qetësia e trupit varet prej ushqimit të paktë.

Qetësia e shpirtit varet prej mëkateve të pakta.

Qetësia e gjuhës varet prej fjalëve të pakta.

## **HUMBJA E MORALIT**

- Nëse humb pasuri, nuk ke humbur asgjë.

- Nëse humb shëndet, ke humbur diçka.

- Nëse e humb moralin, ke humbur çdo gjë.

## **LLOJET E MENDJEVE**

- Mendjet madhështore: të cilat flasin për ide.

- Mendjet e mesme: të cilat flasin për ndodhi.

- Mendjet e vogla: të cilat flasin për njerëzit (çka flasin njerëzit).

## **SUKSESI**

I suksesshëm është:

- ai i cili është i suksesshëm në raport me Zotin e tij;
- ai i cili është i suksesshëm në raport me prindërit e tij;
- ai i cili është i suksesshëm në raport me familjen e tij;
- ai i cili është i suksesshëm në raport me farefisën e tij;
- ai i cili është i suksesshëm në raport me shoqërinë e tij;
- ai i cili është i suksesshëm në raport me gjithë njerëzimin.

## **MIRËSITË**

- Shko në burg për ta kuptuar vlerën, rëndësinë dhe mirësinë e lirisë tënde!
- Shko në spital për ta kuptuar vlerën, rëndësinë dhe mirësinë e shëndetit tënd!
- Shko në varreza për ta kuptuar vlerën, rëndësinë dhe mirësinë e jetës tënde!

Falëndero Zotin për çdo mirësi që të ka dhënë.

## **BAZAT E ÇËSHTJEVE**

Baza e Islamit: besimi në një Zot.

Baza e adhurimit: sinqeriteti.

Baza e moralit: mëshira.

Baza e ligjit: drejtësia.

Baza e veprës: përsosmëria.

Baza e karakterit: shija.

Baza e sjelljes: vëllazëria.

Baza e zhvillimit: baraspesha.

## **NIVELET E FESË**

Nivelet e fesë janë tri:

1. Islami,
2. Imani dhe
3. Ihsani.

Ihsani është niveli më i lartë i fesë.

1. Islami aplikohet nëpërmjet pjesëve të jashtme të trupit.
2. Imani aplikohet nëpërmjet bindjeve dhe veprave të zemrës.

Ndërsa,

3. Ihsani është niveli më i lartë, ngase ato vepra fizike dhe shpirtërore aplikohen me përpikëri dhe para Allahut paraqiten si vepra të kryera me precizitetin më të lartë.

Andaj:

- Veproji veprat me pjesët e trupit me precizitet;
- Veproji veprat me bindje të thellë të zemrës;
- Dorëzoi tek Allahu ato vepra të kryera me precizitetin më të lartë (ihsan).

## **KURIOZITET**

(Shoqëria) Populli i cili e ka edhe fuqinë edhe diturinë – lumë për atë popull.

(Shoqëria) Populli i cili e ka njëriën prej dy cilësive (fuqinë ose diturinë) – në një farë mënyre kalon.

(Shoqëria) Populli i cili nuk e ka as fuqinë, as diturinë – mjerë për atë popull.

## **MËKATI I PARË I NJERIUT**

Mëkati i parë në tokë ndodhi kur Kabili vrau vëllanë e tij vetëm nga zilia.

## **KURIOZITET**

Për shëndet – agjëro!

Për fytyrë të ndriçuar – fal namaz nate!

Për qetësi shpirtërore – lexo Kur'an!

Për lumturi – fal namazet e obliguara në kohët e tyre!

Për të dalë nga problemet – kërko falje mëkatesh!

Për largim të brengave – lutu shumë!

Për largim të vështirësive – thuaj: “La havle ve la kuvete il-la bil-Lah!”

Për mirësi – dërgo sa më shumë salavate për Muhammedin a.s.

Për të pasur respekt ndër njerëz – respektoji ata!

Për të mirën për vete – mendoji ato për të tjerët!

## **URTËSIA E LUKMANIT**

Nga e arrite këtë urtësi? – është pyetur Llukmani i Urtë.

Duke e folur të vërtetën,  
duke zbatuar emanetin (duke qenë besnik dhe i sinqertë),  
duke mos u marrë me çështjet të cilat nuk më takojnë –  
është përgjigjur.

## **LLOJET E FJALËVE**

Kemi dy lloje të fjalëve:

- fjalë të ëmbla, të cilat helmojnë, dhe
- fjalë të hidhura, të cilat shërojnë.

(Kjo nuk nënkupton se fjala e ëmbël nuk shëron dhe fjala e hidhur nuk dëmton).

## **KËSHILLA E BABAIT**

Një baba i tha të birit:

Biri im,

- ushqehu me ushqimin më të mirë;
- fli me gjumin më të ëmbël dhe
- jeto në vendet më të mira.

Po si mund t'i realizoj këto, kur ne jemi të varfër? – i tha i biri.

Në fund, babai i tha të birit:

- nëse ushqehesh kur të jesh i uritur, atëherë ai ushqim është ushqimi më i miri;
- kur të punosh dhe lodhesh e pastaj fle, ai gjumë është gjumi më i ëmbël;
- kur të jetosh në zemrat e atyre të cilëve u ke bërë mirë, ti je duke jetuar në vendet më të mira.

## **FJALË ME VLERË**

Allahu:

- pranimin e veprave e ka lënë të fshehur, ashtu që njeriu të jetë vigilent; ndërsa

- e ka lënë të hapur derën e pendimit, që njeriut t'i mbetet shpresa.

Veprat vlerësohen me përfundimin e tyre. Kjo, që të mos mashtrohet njeriu me veprat e tij.

## **SHPIRTI DHE TRUPI**

Po të ishte trupi dhe pamja më e rëndësishme se shpirti, atëherë shpirti nuk do të ngrihej në qiell e trupi nuk do të varrosej në tokë.

## **BASHKËPUNIMI**

Pasi që bashkëpunojnë në mes vete:

- ai i cili nuk do;
- ai i cili nuk di dhe
- ai i cili nuk mundet.

Atëherë,

le të bashkëpunojnë edhe:

- ai i cili do;
- ai i cili di dhe
- ai i cili mundet.

## **LARGOHU NGA SHTATË CILËSI**

“Largohu nga shtatë cilësi, do ta kesh trupin, mendjen dhe zemrën e shëndoshë, ndërsa pasurinë e fenë tënde të siguruar:

1. Mos u pikëllo për të kaluarën;
2. Mos u brengos për të ardhmen;
3. Mos i ofendo njerëzit siç të ofendojnë ty;
4. Mos kërko shpërblim për atë që nuk e ke punuar;
5. Mos e shiko atë që nuk e posedon;
6. Mos u hidhëro ndaj atij, të cilit hidhërimi yt nuk i bën dëm;
7. Mos u krekos – lavdëro për atë që nuk e ke punuar dhe që nuk është prej teje.”

## **DOBI PREJ FATKEQËSIVE**

Omeri r.a. ka thënë:

“Prej çdo fatkeqësie që më ka ndodhur i kam parë tri dobi prej saj, prej të cilave më ka begatuar Allahu:

E para: se ajo fatkeqësi nuk ka cenuar fenë time, sepse po të kishte qenë ajo fatkeqësi në fenë time, do të kishte qenë fatkeqësi e madhe, prej së cilës njeriu e humb edhe këtë botë edhe botën tjetër.

E dyta: se ajo fatkeqësi ka mundur të jetë më e madhe, sepse çdo fatkeqësi mund të ketë diçka më fatkeqe se ajo fatkeqësi.

E treta: Zoti më ka dhënë durimin, e durimi dhe llogaria në atë fatkeqësi janë baza të sigurisë, me të cilat Allahu e lehtëson fatkeqësinë pasi që të ndodhë.”

**KAPITULLI I DYTË:**  
**RAPORTI ME ALLAHUN**

## **JI ME ALLAHUN**

Deti nuk e fundosi foshnjën e cila ishte në maksimumin e dobësisë, ndërsa

deti e fundosi Faraonin, i cili ishte në maksimumin e fuqisë dhe tiranisë.

Kush është me Allahun, dobësia nuk e dëmton.

Kush nuk është me Allahun, forca nuk i bën dobi.

Bëhu me Allahun, shiko para e mos shiko mbrapa!

## **QETËSIMI I SHPIRTIT**

Kryerja e obligimeve ditore ndaj Krijuesit dhe leximi i këshillave të Krijuesit në Kur'an

e qetëson shpirtin e krijesës (njeriut) gjatë natës.

Dhe:

falja e dy rekateve vullnetare namaz në thellësi të natës

e bën krijesën të jetë aktive, e disponuar dhe e qetë gjatë ditës.

## **PËRMENDJA E ALLAHUT**

- Kur i përmendni njerëzit, zymtoheni dhe zbeheni, ndërsa
- kur i përmendni Allahun, mëshiroheni.

## **KUR TË DO ALLAHU**

- Kur të jetë Allahu i kënaqur me ty, të largon ty nga harami, ndërsa
- kur të do Allahu ty, e largon haramin nga ti.

Zoti i Madhërishëm thotë:

**“Kështu Ne e larguam nga e keqja dhe vepra imorale.”**  
(Jusuf, 24)

## **RROBA E DEVOTSHMËRISË**

Njeriu i cili nuk vishet me rrobën e devotshmërisë është lakuriq, edhe nëse është i veshur.

Rroba e devotshmërisë ndaj Zotit sjell mirësi.

Rroba e cila është në kundërshtim me urdhrat e Zotit nuk sjell dobi.

## **NJËSIA MATËSE**

Njësi matëse te Zoti është devotshmëria e jo fuqia.

Më i miri te Zoti është më i devotshmi.

## **MBËSHTETJA NË ZOTIN**

Organet e njeriut janë:

- organet e brendshme dhe
- organet e jashtme.

- Prej organeve të brendshme është zemra.

- Prej organeve të jashtme janë këmbët, duart, etj.

Organet e jashtme të njeriut, njeriu i lëviz.

Organet e brendshme, si p.sh. zemra, e cila është organi kryesor i njeriut, lëvizin pa dëshirën e njeriut.

Për këtë arsye:

- organet fizike të trupit veprojnë, ndërsa
- zemrën e mbështesim te Zoti.

## **LLOJET E PËRMENDJEVE**

Të përmendësh njerëzit është sëmundje, ndërsa të përmendësh Allahun është shërim.

## **MOSFALËNDERIMI**

Ai i cili nuk e falënderon Allahun për një pikë ujë, i njëjti nuk e falënderon Allahun edhe nëse e ka një vilë.

## **CAKTIMI**

Ta dish:

çka të ka ndodhur, nuk ka mundur të mos ndodhë.

çka nuk të ka ndodhur, nuk ka mundur të ndodhë.

## **KËRKIMFALJA**

Mos mendo shumë, por kërko falje shumë, sepse Allahu fal shumë.

## **LËRI ÇËSHTJET NË KOMPETENCË TË ZOTIT**

I kishte humbur Jusufi, ishte verbëruar, mirëpo kur Jakubi a.s. ishte lutur me lutjen:

“Ve ufevvidu emri ilell-Llah” (Çështjen time e lë në kompetencën e Allahut),

atëherë Allahu ia ktheu edhe djaln Jusuf, edhe shikimin.

## **KAM MENDUAR!**

Ebu Jezid Bestamiu ka thënë:

“Në katër gjëra kisha gabuar:

Kam menduar se unë e kujtoj Atë, para se të më kujton Ai mua;

kujtimi i Allahut ndaj meje është para kujtimit tim ndaj Tij.

Kam menduar se unë e njoh Atë, para se të më njeh Ai mua;

njohja e Allahut ndaj meje është para njohjes sime ndaj Tij.

Kam menduar se unë e dua Zotin para se të më dojë Ai mua;

dashuria e Allahut ndaj meje është para dashurisë sime ndaj Tij.

Kam menduar se unë e kërkoj Allahun; në fund përfundova se:

Allahu më ka kërkuar mua para se ta kërkoj Atë.”

## **VLERA (POZITA) JOTE, VARËSISHT PREJ ANGAZHIMIT TËND**

Nëse dëshiron ta dish vlerën (pozitën) tënde te Zoti, atëherë shikoje veten tënde:

- Nëse të angazhon me përmendje,  
ta dish se Zoti dëshiron të të përmendë ty.
  
- Nëse të angazhon me Kur'an,  
ta dish se Zoti dëshiron të bisedojë me ty.
  
- Nëse të angazhon me vepra të mira,  
ta dish se Zoti dëshiron të afrohet me ty.
  
- Nëse të angazhon me çështjet (bregat) e kësaj bote,  
ta dish se Zoti dëshiron të të largojë nga Vetja e Tij.
  
- Nëse të angazhon me njerëz,  
ta dish se dëshiron të të poshtërojë.
  
- Nëse të angazhon me lutje,

ta dish se Zoti dëshiron të të dhurojë mirësi.

Shiko veten tënde se me çka je i angazhuar...

Vlera dhe pozita jote shkojnë paralelisht me angazhimin tënd.

## **KU FILLOJNË ÇËSHTJET**

Çështjet:

- fillojnë prej Allahut;
- përfundojnë tek Allahu.

Pra:

mos prit para dyerve të njerëzve.

## **QAJ NË SEXHDE**

Mos qaj në jastëkun e shtratit tënd, sepse nuk mund të ndryshosh asgjë,

por qaj në sexhde të sexhades tënde, sepse të qarët në sexhde mund të ndryshojë çdo gjë.

## **ARDHMËRIA**

Vëllezërit e Jusufit kanë menduar se ia kanë shkatërruar Jusufit ardhmërinë e tij,

por Zoti i përdori ata për ta ndërtuar ardhmërinë e Jusufit a.s.

Andaj:

askush nuk mund ta pengojë atë që Allahu e ka caktuar për ty.

Kënaqu me atë që ta ka caktuar Zoti dhe do të jesh më i pasuri i njerëzve.

## **ZOTI MË PËRMEND**

Tha: “Zoti më përmend mua.”

Nga e di ti? – e pyetën.

Nga vetë fjala e Zotit: “Më përmendni Mua, Unë ju përmendi juve.”

Përderisa unë jam duke e përmendur Zotin, Zoti më përmend mua.

## **CILIT T'I PËRGJIGJEM**

Zoti më bën ftesë.

Njeriu më bën ftesë.

Njeriu më cakton kohën e bisedës.

Zoti nuk më cakton kohën e bisedës.

Njeriu më cakton vendin e bisedës.

Zoti nuk më cakton vendin e bisedës.

Njeriu më cakton temën e bisedës.

Zoti nuk më cakton temën e bisedës.

Njeriu më fton, por ai vetë ka nevojë për begati.

Zoti më fton për të më dhuruar begati.

Cilit t'i përgjigjem?

Zotit, i cili ka thënë: "Lutmëni, do t'ju përgjigjem".

## **MENDIMI I KEQ PËR ALLAHUN**

Është pyetur Shafiu r.a.:

Çka nënkuptojmë me fjalën “mendim të keq për Allahun”?

Është përgjigjur:

- duke krijuar vesvese (hamendje) në veten tënde;
- ose duke menduar vazhdimisht se do të të ndodhë ndonjë fatkeqësi;
- ose duke u frikësuar se do të të largohen të mirat nga ti.

Të gjitha këto tregojnë se ti ke mendim të keq për Zotin, Bamirësin e Gjithëmëshirshëm.

## **PARAKTIMI**

Mos e mundo zemrën tënde me frikën e vdekjes nga sëmundja apo nga sëmundjet vdekjeprurëse, sepse çdo gjë ndodh ashtu siç e ka paracaktuar Allahu.

## **KRYELARTËSIA**

Iblisi, kur ka thënë: “Unë jam më i mirë se ai”,

Allahu e ka mallkuar dhe e ka dëbuar nga mëshira e Tij.

Djali i Nuhut, kur ka thënë: “Unë do të ngjitem në majë të malit ku do të sigurohem”,

Allahu e ka përmbytur.

Nemrudi, kur ka thënë: “Unë bëj që të jetojnë dhe të vdesin njerëzit”,

Allahu e ka shkatërruar.

Faraoni, kur ka thënë: “Unë jam Zoti më i madh”,

Allahu e ka përmbytur.

Karuni, kur ka thënë: “Unë këtë pasuri e kam arritur me diturinë time”,

e ka përpirë toka.

## **KUR TË MBËSHTETË ZOTI**

Të jesh i sigurt:

nëse Zoti të mbështet në diçka, çdo gjë e nënshtron për ty, aq sa, sipas mendimit tënd, do ta konsideroje të pamundur që të realizohet.

## **BESIMTARI I FORTË**

“Besimtari i shëndoshë dhe i fuqishëm është më i dashur te Allahu se besimtari i sëmurë dhe i dobët.

Angazhohu për çdo të mirë dhe për atë që është e dobishme.

Mbështetu në Allahun dhe mos u bë i paaftë.

Nëse të ndodh diçka, mos thuaj: ‘Ah, sikur të kisha vepruar kështu, do të bëhej kështu’,

por thuaj: ‘Caktimi i Allahut; çka ka dashur Allahu është bërë’,

sepse fjala ‘sikur’ hap dyert e veprimit të shejtanit.”

## **NDRYSHIM I LIGJEVE TË NATYRËS**

Nëse dëshiron Allahu, i ndryshon edhe ligjet e fizikës dhe ligjet e natyrës, ashtu që:

- zjarri të mos djegë;
- deti të mos fundosë;
- kodra të mos rrëzohet;
- peshku të mos gëlltisë;
- shterpa të mbetet shtatzënë;
- virgjëresha të lindë;
- thika të mos presë;
- i zhdukuri të bëhet udhëheqës;
- foshnja e porsalindur të flasë;
- hëna të çahet dhe
- dielli të ndalet.

Të gjitha këto mund të ndodhin vetëm me një fjalë: “Bëhu!”, dhe ajo bëhet.

Allahu vepron në gjithësi në bazë të dëshirës dhe urtësisë së Tij.

## **LLOJET E TREGTIVE**

Kemi dy lloje të tregtisë:

- tregtinë në mes njerëzve dhe
- tregtinë me Allahun.

Në tregtinë në mes njerëzve:

- ndonjëherë humb shitësi;
- ndonjëherë humb blerësi.

Në tregtinë me Allahun:

- blerësi është Allahu i Madhërishëm;
- shitësi është besimtari;
- malli tregtar është shpirti i besimtarit dhe pasuria e tij;
- profiti i tregtisë është Xheneti.

Në tregti me Allahun, shitësi kurrë nuk mund të dështojë, gjithmonë rezulton me profit.

Allahu i Madhërishëm thotë:

**“Pa dyshim se Allahu i blen prej besimtarëve shpirtrat dhe pasurinë e tyre me këmbim të Xhenetit për ta.”**  
(Et-Tevbe, 111)

Allahu ia jep besimtarit jetën dhe pasurinë, pastaj e blen jetën dhe pasurinë e besimtarit në këmbim të Xhenetit.

## **SHËRIMI NGA SËMUNDJA E LARGIMIT PREJ ALLAHUT**

Nëse dëshiron të shërohesh nga sëmundja e largimit prej Allahut, merr:

- gjethet e durimit;
- lëngun e modestisë.

Këto vendosi në enën e devotshmërisë.

Pastaj:

hedh mbi to ujin e frikës ndaj Allahut;  
vloji këto me zjarrin e pikëllimit dhe  
vendosi në tryezën e inspektimit.

Pastaj:

përdori me dorën e drejtësisë;  
pije me gotën e istigfarit;  
përtypi me gojën e përkushtimit dhe  
largoje veten nga lakmia dhe pangopësia.

Atëherë, me lejen e Allahut, do të shërohesh.

## **ÇËSH TJJA E DASHUR DHE E URRYER**

Kemi dy lloje të çështjeve:

- çështje të dashura dhe
- çështje të urryera.

Ndodh që:

“e kemi dashur një çështje, por në fund prej saj ndodhë e keqja”, ose

“e kemi urryer një çështje, por në fund prej saj ndodhë e mira”.

Çështjet që ndodhin mbi ne pa dëshirën dhe pa vullnetin tonë, mendja duhet t’i nënshtrohet urtësisë së Zotit:

- nëse të godet ndonjë e keqe për shkak të neglizhencës tënde në atë çështje, ti je i ndëshkuar;
- nëse të godet ndonjë e keqe në një çështje në të cilën nuk ke kompetencë, duhet të jesh i sigurt se Allahu ka paraparë urtësi për atë çështje.

Çështjet shkojnë paralelisht me urtësinë e Zotit dhe nuk shkojnë në bazë të mendjes sonë, e cila është e kufizuar.

## **LIDHJA ME ALLAHUN DHE LIDHJA ME FAREFISIN**

Lidhja me Allahun e Gjithëmëshirshëm bëhet nëpërmjet lidhjes farefisnore.

Ne sot mund të shohim se:

- janë shkëputur lidhjet farefisnore për shkak të arritjes së një pozite të lartë;
- janë shkëputur lidhjet farefisnore për shkak të realizimit të një interesi të ngushtë;
- janë shkëputur lidhjet farefisnore për shkak të arritjes së një profesioni;
- janë shkëputur lidhjet farefisnore për shkak të mosdhënies së një borxhi;
- janë shkëputur lidhjet farefisnore për shkak të arritjes së një pasurie duke bërë biznes, etj.

Duke vrapuar drejt pasurisë, janë ndërprerë lidhjet farefisnore, kështu që nënë, babë, vëlla, motër, axhë, dajë, etj., janë zëvendësuar me pasurinë dhe materializmin.

Pasi që janë shkëputur lidhjet farefisnore, prapë duhet t'i ndërlihim.

Ta dëgjojmë dhe ta praktikojmë thënien e Zotit të  
Lartëmadhëruar në hadithin kudsij:

***“Unë jam i Gjithëmëshirshmi dhe lidhja farefisnore e ka  
prejardhjen prej emrit Tim.***

***Kush i ndërlidh lidhjet farefisnore, ai i ka lidhur  
marrëdhëniet me Mua;***

***dhe kush i ka shkëputur lidhjet me ta (farefisnin), i ka  
shkëputur marrëdhëniet me Mua.”***

## **KAPITULLI TRETË:**

### **LUTJA**

## **LOTI DHE LUTJA**

Loti për të vdekurin nuk mund ta kthejë të vdekurin te familja për ta gëzuar familjen e tij, por

lutja për të vdekurin mund ta kthejë vuajtjen në gëzim për të vdekurin në varr.

## **LUTJA**

Kur Zoti ia mundëson një njeriu që të lutet sa më shumë dhe sa më shpesh, është dëshmi se e do atë njeri.

Lutu, mos u ndal, lutu derisa edhe gjuha të teret së luturi, sepse edhe nëse mendon se lutja nuk të është pranuar, në esencë lutja e shpeshtë të afron më shumë te Allahu dhe Ai, me urtësinë e Tij, ka për ta pranuar lutjen tënde në kohën më të përshtatshme për ty, edhe nëse vonon.

## **LUTJA DHE VEPRIMI**

Lutu dhe vepro.

Veprimi pa lutje mund të dështojë.

Lutja pa bindje dhe veprim mund të dështojë.

## **LUTJE**

Për sëmundje

Ejubi a.s. është lutur: “Më kaploi sëmundja, ndërsa Ti je më i Mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve.”

Për sprova

Junusi a.s. është lutur: “La ilahe il-la ente, subhaneke, inni kuntu mine’dh-dhalimin.”

“Nuk ka Zot tjetër pos Teje, Ty të takon lavdërimi, ndërsa unë vetë isha prej të padrejtëve.”

Për fëmijë

Zekerijai a.s. është lutur: “Mos më lër të vetëm, edhe pse Ti je Trashëgimtari më i Miri.”

Në këto lutje, Zoti është përgjigjur pozitivisht, ku thotë:

“Në ju përgjigjëm pozitivisht atyre.”

Andaj,

kur lutesh, mos e humb shpresën; detyra jote është të lutesh, e çështjen tjetër dorëzoje tek Allahu.

## **LUTJA**

Kur e lut Zotin dhe Ai nuk ta realizon atë që dëshiron, dije se:

- Zoti është duke vepruar me ty paralel me botëkuptimin tënd dhe
- paralel me urtësinë e Tij ndaj jush.
- Nuk e ke marrë përgjigjen e dëshiruar në bazë të botëkuptimit tënd, mirëpo
- Zoti të është përgjigjur në bazë të Urtësisë së Tij.

Shembull

Djali yt të lut: më bli një revole.

Ti mendon se ai, duke luajtur me atë revole, mund të vrasë ndonjë njeri.

Ti e qetëson (dhe nuk ia blen revolen).

Nëse vepron kështu, ti i ke dhënë më shumë se ç'dëshiron djali, sepse ai ka dashur të zbavitet me atë revole; në esencë nuk ia ke përmbushur dëshirën e tij, sepse ti nuk ke dashur t'i ndodhë e keqja.

Duke e larguar nga dhënia (e revoles), ti e ke larguar nga e keqja.

Për këtë arsye, për të na qetësuar, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

**“Njeriu lutet për të keq dhe për të mirë. Njeriu është i ngutshëm.”** (El-Isra: 11)

Ti thua: më jep këtë, sepse ti mendon se është e mirë për ty, por në esencë ajo është e keqe për ty.

Kur Zoti i Lartmadhëruar të ka penguar nga e kërkuara, Ai të ka penguar nga e keqja, mirëpo ti mendon se nuk të është përgjigjur në kërkesën tënde.

Allahu të është përgjigjur dhe të ka dhënë të mirën, por:

- ajo e mirë është siç e sheh Ai dhe

- ajo e mirë nuk është siç e sheh dhe e mendon ti.

## **LUTJA KËRKON PAK FJALË**

Lutja kërkon pak fjalë dhe shumë sinqeritet, andaj lutu me sinqeritet dhe me pak fjalë.

Lutja e Nuhut, me pak fjalë, e ka përmbytur rruzullin tokësor:

“Jam i mundur, më ndihmo!”

Lutja e Sulejmanit, me pak fjalë, i ka sjellë mbretëri të madhe:

“Më dhuro pushtet i cili nuk do t’i përket askujt pas meje.”

## **GËZOHEM KUR NUK MË PRANOHET LUTJA**

Një dijetar ka thënë:

“Unë e lus Allahun kur kam nevojë dhe, nëse ma dhuron kërkesën, gëzohem një herë; por nëse nuk ma plotëson atë, gëzohem dhjetë herë, sepse e para ishte zgjedhja ime, ndërsa e dyta ishte zgjedhja e Allahut.”

## **PSE NUK PRANOHEK LUTJA**

E kanë pyetur Ibrahim ibn Ed'hemin: “Çka është me ne që i lutemi Allahut, por Ai nuk na e pranon?”

Ai u thotë: “Për shkak se zemrat tuaja janë të vdekura në dhjetë çështje:

E para: E njihni Allahun dhe nuk i kryeni obligimet e Tij.

E dyta: Deklaroni se e doni të Dërguarin e Allahut s.a.v.s., e nuk veproni sipas sunetit të tij.

E treta: E lexoni Kur'anin dhe nuk veproni me të.

E katërta: I shfrytëzoni të mirat e Allahut, e nuk e falënderoni.

E pesta: Thoni se shejtani është armiku juaj, e nuk e kundërshtoni.

E gjashta: Thoni se xheneti është i vërtetë, e nuk punoni për të.

E shtata: Thoni se xhehenemi është i vërtetë, e nuk largoheni prej tij.

E teta: Thoni se vdekja është e pashmangshme, e nuk përgatiteni për çastin e saj.

E nënta: Zgjoheni nga gjumi, i shihni të metat e të tjerëve, e i harroni tuajat.

E dhjeta: I varrosni të vdekurit, e nuk llogaritni se do t'ju ndodhë njësoj si atyre.”

**KAPITULLI KATËRT:**

**EDUKATA**

## **EDUKATA**

Edukata as nuk blihet, as nuk shitet,  
por është natyrshëmëri e çdo zemre të edukuar.

## **I VARFËRI**

Nuk quhet i varfër ai i cili e humb pasurinë (arin),  
por i varfër quhet ai i cili e humb karakterin, edukatën dhe  
moralin.

## **EDUKIMI I FËMIJËS**

Nëse ti nuk ke kohë ta edukosh fëmijën tënd, atëherë  
të tjerët kanë kohë ta degjenerojnë fëmijën tënd.

## **EDUKATA PARA JOSHJES DHE MASHTRIMIT**

Zelihaja nuk e arriti qëllimin e saj që, me joshje dhe me  
mashtrim, ta bëjë për vete Jusufin a.s., ndërsa  
vajza e Shuajbit, me moral, ia arriti qëllimit të martohet me  
Musain a.s.

## **FYTYRA E NDRITUR**

Të parët tanë kanë jetuar pa rrymë, por kanë pasur ndriçim në fytyrë.

Sot jetojmë me rrymë, ndërsa pa ndriçim në fytyrë.

Shkaku i humbjes së dritës së fytyrës është: humbja e moralit.

## **UDHËTIMI PA DESTINACION**

- Dielli lundron (udhëton) në destinacionin e duhur.

- Hëna lundron (udhëton) në destinacionin e duhur.

- Toka lundron (udhëton) në destinacionin e duhur.

Të gjitha këto formojnë vitin kalendarik, ndërsa

- disa njerëz kërkojnë të udhëtojnë pa destinacion.

## **PËRTACIA DHE PAAFTËSIA**

Përtaci është atëherë kur trupi është i aftë, por zemra nuk dëshiron.

Paaftësi është kur zemra dëshiron, por trupi nuk ka aftësi.

## **LLOJET E MBETURINAVE**

Kemi dy lloje të mbeturinave:

- mbeturina konkrete (të materieve) dhe
- mbeturina abstrakte (kuptimore).

- Mbeturinat konkrete i shfrytëzojnë dhe i konsumojnë kafshët, shpezët, gjallesat dhe bimët.

- Mbeturinat abstrakte (kuptimore), si p.sh.: urrejtjen, xhelozinë, gënjeshtat, fabrikimin e shpifjeve dhe mbeturinat e tjera abstrakte, i konsumojnë njerëzit.

## **LLOJET E PASTËRTIVE**

Kemi dy lloje të pastërtive:

1. Pastërtia fizike dhe
2. Pastërtia shpirtërore.

Pastërtia fizike duhet të manifestohet në pastërtinë shpirtërore.

Pastërtia shpirtërore duhet të manifestohet në pastërtinë fizike.

Përfundim: Njeriu përbëhet prej trupit dhe shpirtit.

## **ME MIRËSI**

Tri gjëra me mirësi:

- durim me mirësi dhe të bukur;
- falje me mirësi dhe të bukur;
- largim me mirësi dhe të bukur.

Pra:

Kur të duroni, duroni me durim të mirë dhe të bukur.

Kur të falni, falni falje të mirë dhe të bukur.

Kur të largoheni nga injorantët, largohuni me të mirë, të bukur dhe pa dëmtim.

## **ÇMIMI I LARTË DHE VEPRAT ME ÇMIM TË LARTË**

Çmimi i ujit dhe qumështit në xhenet është i lartë, por aty mund të arrihet me vepra të cilat i kanë çmimet e larta, sepse veprat e mira ngrihen lart për të paguar çmimin e vlerës së lartë të ujit të xhenetit, të qumështit të xhenetit dhe të artikujve të tjerë ushqimorë të xhenetit.

## **EDUKATA E INJORANTIT**

Prej edukatës së injorantit:

- përgjigjet para se të dëgjojë (pyetjen, çështjen);
- kundërshton para se të kuptojë;
- gjykon para se të mësojë.

## **NEVOJA PËR EDUKATËN E TRUPIT**

Njeriu, ashtu siç ka nevojë për mbrojtjen e trupit, ka nevojë edhe për forcimin e edukatës dhe moralit në trupin e tij.

## **SI DUHET NGRËNË DHE SI DUHET FJETUR?**

Një grua kalon pranë një tubimi dhe pyet:

— Cili është më i dituri nga ju?

Me shenjë i tregojnë te njëri prej tyre.

Shkon te fekihu (dijetari) dhe e pyet:

— Si ushqehesh?

Ai i thotë:

— E përmendi Allahun, ha me të djathtën, e marr atë që më takon, e marr pjesën më të vogël të ushqimit dhe e përtyp mirë.

Pastaj e pyet:

— Si fle?

— Marr abdes, mbështetem në krahun e djathtë dhe i lexoj lutjet e mbrëmjes.

Ajo i thotë:

— Ti nuk ke njohuri as se si duhet ngrënë dhe as si duhet fjetur?!

Të pranishmit e shikojnë me habi, ndërsa fekihi (dijetari) e pyet:

— Atëherë na trego ti se si duhet ngrënë dhe si duhet fjetur?

Ajo i thotë:

- Të mos hyjë në barkun tënd ushqim haram, atëherë ha si të duash!

- Të mos ketë zili në zemrën tënde, atëherë fle si të duash!

Atë që më tregove ti është edukata (mirësjellja) e asaj çështjeje, ndërsa atë që të tregova unë është thelbi i çështjes.

Shumica e njerëzve i kushtojnë rëndësi anës së jashtme të çështjes, kështu që nuk e realizojnë suksesin e thelbit të çështjes.

A e di se çka është thelbi i suksesit të çështjes?

(Përgjigjja) Arabët nuk kanë shkëlqyer në bazë të veshjes së Pejgamberit, as në bazë të ushqimit të tij, as me mënyrën e pijes së tij, por ata kanë shkëlqyer me madhësinë e edukatës së Pejgamberit; kanë shkëlqyer me sjelljen e Pejgamberit, kanë shkëlqyer me moralin e Pejgamberit, kanë shkëlqyer me butësinë e Pejgamberit.

Për këtë arsye, në atë kohë, nga çobanë të dhenve janë bërë udhëheqës të njerëzimit.

**KAPITULLI PESTË:**  
**FAMILJA DHE SHOQËRIA**

## **KUR DOMINON E KEQJA**

E keqja dominon atëherë kur:

- i mençuri nënçmohet,
- i mallkuari nderohet,
- mendjelehti respektohet.

## **DY BABALLARË**

- Njëri i thotë djalit: -Jepe jetën për rrugën e drejtë.

Djali e dëgjon dhe shpëton.

- Tjetri i thotë djalit: -Mos vdis, eja jeto në rrugë të drejtë.

Djali nuk e dëgjon, kështu që mbytet.

## **DËSHIROJ FËMIJË TË MIRË**

Më tha: Dëshiroj fëmijë të mirë.

I thashë: Nëse dëshiron fëmijë të mirë, bëhu vet i mirë.

Zoti i Madhërishëm tregon se Hidri i ka thënë Musait a.s.:

**“Prindi i tyre ka qenë i mirë”.**

Më tha: Dëshiroj fëmijë të mirë.

I thashë: Nëse dëshiron fëmijë të mirë, lutu për ta.

Zoti i Madhërishëm tregon lutjen e Ibrahimit a.s. dhe na ka mësuar të lutemi sikurse Ibrahimit a.s.:

**“Më bë të mirë mua dhe fëmijët (pasardhësit) e mi”.**

Më tha: Dëshiroj fëmijë të mirë.

I thashë: Nëse dëshiron fëmijë të mirë, fale namazin dhe lutu që edhe ata ta falin namazin.

Zoti i Madhërishëm tregon lutjen e Ibrahimit a.s. dhe na ka mësuar të lutemi sikurse Ibrahimit a.s.:

**“Zoti im, më bëj mua që ta fal namazin dhe fëmijët (pasardhësit) e mi gjithashtu”.**

Më tha: Dëshiroj fëmijë të mirë.

I thashë: Nëse dëshiron fëmijë të mirë, kërko mbrojtje për ta nga shejtani i mallkuar.

Zoti i Madhërishëm na e tregon lutjen e gruas së Imranit për fëmijën:

**“Dhe unë kërkoj mbrojtje te Ti për të dhe për pasardhësit e saj nga shejtani i mallkuar”.**

## **PËRKUJDESI PËR SHOQËRINË**

Edhe pse buburreci ishte i vogël,

përkujdesej për shoqërinë e buburrecave.

Nuk hyri në vendbanimin e tij pa ua treguar të tjerëve.

Buburreci ka pasur ndjenjë përgjegjësie:

- është përkujdesur për sigurinë e shoqërisë së buburrecave;
- është përkujdesur për qetësinë e shoqërisë së buburrecave;
- është përkujdesur për lumturinë e shoqërisë së buburrecave;
- është përkujdesur që të mos dëmtoheshin dhe të mos shkatërroheshin.

Në fund, buburrecat hynë në strofujt e tyre dhe shpëtuan.

## **SELAMI**

Selamin e japim në xhami ose në rrugë.

Kur të çelim derën e shtëpisë (banesës), nuk japim selam për veten tonë.

Selami jepet edhe para hyrjes në shtëpi (banesë) kur nuk ka asnjë anëtar të familjes.

Selami jepet edhe para hyrjes në shtëpi (banesë) kur janë anëtarët e familjes.

Selami i jepet prindërve në shtëpi.

Selami i jepet fëmijëve në shtëpi.

Selami i jepet vëllezërve në shtëpi.

Selami i jepet motrave në shtëpi.

Selami i jepet edhe në telefon para fillimit të bisedës.

Nuk ka fillim bisede pa dhënien e selamit.

Edhe Zoti i Lartëmadhëruar do t'i përshëndesë banorët e xhenetit me selam:

**“Selamun kavlen min Rabbin Rahim.”**

**“Paqe” do të jetë përshëndetja nga Zoti i Gjithëmëshirshëm.**

## **NDËRTIMI I XHAMIVE**

Ajeti kur'anor: -"Innemâ je'muru mesâxhidell-Llah..."- ka kuptimin për ata të cilët i ndërtojnë dhe i mirëmbajnë shtëpitë e Allahut (xhamitë).

Pra, ai i cili ndërton xhami:

- ka shpërblimin e atyre që falen në atë xhami;
- ka shpërblimin e atyre që bëjnë dhikër në atë xhami;
- ka shpërblimin e atyre që bëjnë tesbih në atë xhami;
- ka shpërblimin e atyre që zhvillojnë aktivitete islame në atë xhami.

Ai i cili e mirëmban xhaminë:

- ka shpërblimin e atyre që falen në atë xhami;
- ka shpërblimin e atyre që bëjnë dhikër në atë xhami;
- ka shpërblimin e atyre që bëjnë tesbih në atë xhami;
- ka shpërblimin e atyre që zhvillojnë aktivitete islame në atë xhami.

## **NJERIU**

Allahu në Kur'an tregon se:

**“Ne e kemi krijuar njeriun në formën më të bukur”** (Et-Tin, 4):

- me sy të bukur,
- me duar të mira,
- me këmbë të forta dhe
- me trup të shëndoshë.

Allahu në Kur'an tregon se:

**“Pastaj e kthejmë atë në nivelin më të ulët të të ultëve”** (Et-Tin, 5):

- i ka po ata sy, por i dobësohet shikimi – i nevojiten syze;
- i ka këmbët, por nuk mund të ecë me to – i nevojitet asistencë;
- i ka duart, por nuk mund të ushqehet me to – i nevojitet asistencë;
- ka nevojë të pastrohet, nuk mund të pastrohet vetë – i nevojitet asistencë.

Të shëndetshmit e harrojnë:

- pleqërinë,
- vdekjen,
- botën tjetër dhe
- llogaridhënien.

Pleqëria vjen dalëngadalë si shenjë paralajmëruese.

Vdekja vjen në befasi si shenjë paralajmëruese për të tjerët.

Bota tjetër dhe llogaridhënia vijnë pas pleqërisë dhe vdekjes.

## **TEORIA: 99-1**

Kjo do të thotë: kur të janë dhënë 99 mirësi dhe nuk ua di vlerën atyre 99 mirësive, por vrapon pas të 100-tës, e cila nuk është shkruar për ty.

**KAPITULLI GJASHTË:**  
**POZITA, PARAJA DHE DITURIA**

## **DIJETARI DHE PARAJA**

Dijetari fetar është mjeku i njeriut fetar, ndërsa paraja është sëmundja e njeriut fetar.

– Nëse dijetarin e fesë e rrëmben sëmundja e parasë, atëherë

kush do ta shëronte pacientin e sëmurë fetar?

## **DITURIA**

Dituria:

– Është mjet i ngritjes së vlerës dhe pozitës në këtë botë dhe në botën tjetër.

Dituria:

– Është mjet i suksesit dhe shpëtimit në këtë botë dhe në botën tjetër.

## **DITURIA DHE PASURIA**

Dituria është trashëgimi e peygamberëve, ndërsa pasuria është e trashëguar prej faraonëve.

Dituria të ruan dhe të mbron ty, ndërsa pasurinë ti duhet ta mbrosh.

Dituria rritet edhe nëse shpenzohet, ndërsa pasuria nga ky akt zvogëlohet.

Diturinë nuk mund ta vjedhë askush nga ti, ndërsa pasurinë mund ta vjedhë çdokush nga ti.

Dituria e ndriçon mendjen, ndërsa pasuria nuk mund ta ndriçojë atë.

## **HARAMI DHE HALLALI**

Harami – nuk të ngop edhe nëse është i shumtë.

Hallalli – të mjafton edhe nëse është i paktë.

## **MJETET E DITURISË**

Mjetet e diturisë janë:

- Dëgjimi,
- Shikimi dhe
- Mendja (zemra).

– Dëgjimi është mjet diturie, sepse në të kalojnë njohuritë në mes të njerëzve nëpërmjet transmetimeve.

– Shikimi është mjet me të cilin bëhen vërejtjet dhe përvojat; me të zhvillohen shkencat e gjithësisë.

– Mendja (zemra) është mjeti për të përpunuar dëgjimet dhe pamjet dhe, në fund, nxjerr rezultatet përfundimtare për të ardhmen.

Zoti i Lartëmadhëruar thotë:

**“Allahu ju ka nxjerrë nga barqet e nënave tuaja, kur nuk keni ditur asgjë, ju ka dhënë dëgjimin, shikimin dhe mendjet (zemrat), me qëllim që të jeni mirënjohës.”** (En-Nahl: 78)

## **PASURIA, MATERIALIZMI, FAMA DHE POZITA**

Karuni e ka ditur përmendësh librin e Zotit, Tevratin, mirëpo:

- Pasuria (materializmi, fama dhe pozita) ia ka verbuar sytë Karunit;
- Pasuria (materializmi, fama dhe pozita) ia ka paaftësuar dëgjimin Karunit;
- Pasuria (materializmi, fama dhe pozita) ia ka ngurtësuar trurin Karunit, ashtu që për shkak të pasurisë (materializmit, famës dhe pozitës) është fundosur në thellësi të tokës dhe e tërë pasuria e tij e ka varrosur në tokë.

Mos lejo që pasuria, fama dhe pozita të bëhen sytë e tu, e as dëgjimi yt, e të mos flasim të bëhen edhe mendja jote!

## **LLOJET E TË PASURVE**

Të pasurit janë katër llojesh:

1. Të pasurit të cilët e fitojnë pasurinë haram dhe e shpërndajnë në haram.

(Dënohen me zjarr)

2. Të pasurit të cilët e fitojnë pasurinë hallall dhe e shpërndajnë në haram.

(Dënohen me zjarr)

3. Të pasurit të cilët e fitojnë pasurinë haram dhe e shpërndajnë në hallall.

(Dënohen me zjarr)

4. Të pasurit të cilët e fitojnë pasurinë hallall dhe e shpërndajnë në hallall.

(Shpërblehen në botën tjetër)

## **KRENARIA**

- Tregtarët krenohen me profitin, por sa është i drejtë dhe i merituar ai profit kur shkon në dëm të konsumatorit?

- Ekonomistët krenohen se kanë realizuar të hyra marramendëse me kamata, edhe pse ato kamata i kanë përplotur shumicën e klientëve (qytetarëve).

- Politikanët krenohen me aftësitë e tyre për të mashtruar nën petkun e të ashtuquajturës “diplomaci”, edhe pse në kuptimin pozitiv mashtrimi nuk quhet aftësi, por ligësi.

- Bujqësia krenohet me shtimin e rendimenteve bujqësore, edhe pse ai shtim nuk bëhet në mënyrë natyrale, por në mënyrë artificiale, të cilat rendimente më shumë e dëmtojnë njeriun (lukthin e tij) sesa e ushqejnë dhe i sjellin dobi.

- Mediet krenohen me informim sa më të shpejtë, edhe pse ajo informatë më vonë nuk del të jetë e saktë.

- Mjekësia krenohet me plastifikimin e çdo pjese të njeriut, edhe pse ai plastifikim është vetëm një ambalazh, i cili e fsheh të metën, ndërsa e dëmton trupin e njeriut edhe më shumë.

Të krenuarit vazhdojnë, por edhe lëvdatat për të krenuarit nuk kanë të ndalur.

## **PROVIMI I PASURISË, I SHËNDETIT DHE I FËMIJËVE**

Ejubi a.s. u sprovua:

- Me pasuri;
- Me humbje të fëmijëve dhe
- Me shëndet.

Shejtani, i cili ishte prej xhinëve, shkon te Ejubi a.s. dhe i thotë: Po të të kishte dashur Zoti, nuk do të të kishte sprovuar me këto sprova.

Ejubi a.s. i përgjigjet: Largohu, o i mallkuar, se Zoti më ka dhënë atë e cila është më e vlefshme se çdo gjë:

- Zemrën, e cila ka bindje të thellë dhe nuk e harron kurrë Zotin, dhe
- Gjuhën për ta përmendur Zotin.

## **HIDRI**

- Hidri e mbyti fëmijën, i cili po të rritej do t'i detyronte prindërit të largoheshin nga besimi në Zot.
- Pasuria e largoi Karunin nga Musa a.s. Edhe pse ishte hafiz i Tevratit, pasuria e fundosi Karunin në tokë.
- Faraoni, i cili thoshte: “Unë jam Zoti më i madhi dhe këta lumenj qarkullojnë nën mua”, ndikoi që të fundosej në det.

## **USHQIMI HALLALL**

Nga kodrina “Safa”, Haxherja e ka bërë vrapimin deri në kodrinën Merva për të siguruar ushqim për beben e saj Ismailin, i cili ka pranuar të sakrifikohet, ka pranuar të bëhet kurban.

Kur prindërit i ushqejnë fëmijët me ushqim hallall dhe i edukojnë me edukatë të mirë, ata fëmijë bëhen shembull për të mirë.

## **I DITURI DHE I URTI**

I dituri të mëson se:

- Kjo është e keqe.
- Ajo është e mirë.

Pra, ta mëson ta dallosh të mirën nga e keqja.

I urti të mëson se:

- Kjo e keqe është më e lehtë se e keqja tjetër.
- Kjo e mirë është më me vlerë se e mira tjetër.

Pra:

- Të mëson të dallosh të keqen prej dy të këqijave se cila është më e keqe.
- Të mëson ta dallosh të mirën prej dy të mirave se cila është më e mirë.

## **NUK E DI**

E kanë pyetur Sheabiun për një çështje.

Ai u ka thënë: “Nuk e di!”

Ata i thonë: A nuk po ke turp të thuash “nuk e di”, përderisa je muftiu i Irakut?!

Ai u thotë: Melekët nuk janë turpëruar kur i kanë thënë Zotit: “Nuk kemi njohuri pos asaj që na ke mësuar!”

## **GRAMATICIENTI**

I është thënë një gramaticienti: Na përshkruaj gjendjen momentale?

Gramaticienti është përgjigjur si në vijim:

“Morali”: Folja në kohën e kaluar;

“Dhuna”: Folja urdhërore;

“Lufta”: Folje në kohën e ardhshme;

“Politikanët”: Aktivi (i foljes);

“Populli”: Pasivi (i foljes);

“Pasuria”: Të vepruarit në të;

“Kaosi”: Atributi (i fjalisë);

“Rrogat”: Të palakuarat (e fjalisë);

“Ndërgjegjja”: Përemri në mendje;

“Interesi”: Kryefjala;

“Patriotizmi”: Kallëzuesi;

“Siguria”: Mohuesi i fjalisë dhe

“Gënjeshtër”: Rikonfirmimi i fjalisë.

## **LLOJET E MENDIMEVE**

Janë dy lloje të mendimeve:

- Mendimet destruktive dhe
- Mendimet konstruktive.

Mendimet destruktive janë mendimet të cilat shkojnë pas injorancës; çka do që flitet, e dëgjojnë dhe e pranojnë pa logjikë të shëndoshë.

Mendimet konstruktive janë mendimet të cilat pranohen me argumente dhe i nënshtrohen logjikës, dhe shkojnë pas përvojës në materie dhe i përdorin mjetet të cilat ua ka dhuruar Zoti – e ato mjete janë: dëgjimi, shikimi dhe mendja (zemra).

Zoti i Lartëmadhëruar thotë:

**“Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke dituri, pse për shqisën e të dëgjuarit, për shqisën e të shikuarit dhe mendjen (zemrën), për të gjitha këto pason llogaridhënia.” (Isra: 35)**

## **SPROVAT E EJUBIT A.S.**

Sot shohim:

- Nëse ndokush nuk ka fëmijë, menjëherë mendon se nëpërmjet xhinëve i është bërë magji.
- Nëse ndokush nuk ka pasuri, menjëherë mendon se nëpërmjet xhinëve i është bërë magji.
- Nëse ndokush bëhet i plogësht dhe dobësohet me shëndet, mendon se nëpërmjet xhinëve i është bërë magji.

Shejtani, i cili është nga xhinët, ia zbukuron veprat njeriut dhe ai zbukurim i veprave bëhet edhe me pasuri, edhe me fëmijë, edhe me shëndet, të cilat çështje mund të ndikojnë që ta largojnë njeriun nga rruga e drejtë, ndërsa anti-xhin dhe anti-shejtan janë:

- Bindja e thellë në Allahun;
- Përmendja e Allahut;
- Devotshmëria.

Ejubi a.s. e ka dhënë provimin te Zoti i Lartëmadhëruar, për këtë arsye Zoti ia kompensoi prapë me pasuri, me fëmijë dhe me shëndet, ndërsa ne, pa e dhënë provimin te Zoti i Lartëmadhëruar, mendojmë të na kompensohet me pasuri, me fëmijë dhe me shëndet.

## **DY PACIENTËT**

Dy pacientë shkojnë te mjeku:

- Njëri i pasur.
- Tjetri i varfër.

Mjeku i bën analizat e të pasurit dhe vjen në konkludim se:

- I pasuri kishte yndyrë të tepruar dhe shtypje të gjakut.

Kjo nga shkaku se i pasuri konsumonte ushqim të tepruar dhe nuk angazhohej fizikisht.

Pastaj i bën analizat e të varfrit dhe vjen në konkludim se:

- I varfri kishte mungesë të gjakut dhe yndyrë të paktë në trup.

Kjo nga shkaku se i varfri nuk konsumonte ushqim të mjaftueshëm dhe angazhohej (punonte) për së tepërmi.

Nëse i pasuri angazhohet më shumë dhe konsumon ushqim më pak, dhe në anën tjetër i varfri konsumon ushqim më shumë dhe angazhohet (punon) më pak, atëherë do të nivelizohet gjaku i të dyve.

Nëse i pasuri do të aktivizohet fizikisht më shumë dhe i varfri më pak, do të nivelizohet shëndeti i të dy pacientëve.

Kjo ndodh vetëm nëse dëgjohen këshillat e Krijuesit (Allahut).

## **FRIKA NGA RIZKU**

Për ata të cilët:

- Frikësohen se do të ndëshkohen nga qeveritarët dhe
- Frikësohen nga çështja e furnizimit (rizkut).

Zoti i Lartëmadhëruar në suren Kurejsh thotë:

**“Ata të cilët i ushqen nga uria (ua garanton furnizimin) dhe i siguron nga frika.”** (El-Kurejsh: 4)

Këto dy elemente (frika nga ndëshkimi prej qeveritarëve dhe frika nga rizku/furnizimi) destabilizojnë dhe shkaktojnë kriza në gjithë rruzullin tokësor.

Për këtë arsye Zoti i Lartëmadhëruar thotë: Unë ju siguroj dhe ju garantoj rizkun (furnizimin); angazhohuni në punën tuaj pa pasur brenga nga këto dy çështje.

Zoti i Lartëmadhëruar në hadithin kudsij thotë:

- O biri i Ademit,

mos u frikëso prej qeveritarit përderisa sundimi im nuk përfundon.

- O biri i Ademit,

mos u frikëso nga vështirësia dhe ngushtimi i furnizimit (rizkut), përderisa magazinat e mia nuk zbrazen asnjëherë.

– O biri i Ademit,

mos kërko dikë tjetër pos meje, sepse Unë jam Allahu; nëse më kërkon, do të më gjesh, nëse largohesh nga Unë, Unë largohem nga ti, dhe atëherë do t'i humbësh të gjitha të mirat.

– O biri i Ademit,

të kam krijuar për adhurim dhe mos u largo nga adhurimi; të kam garantuar furnizimin (rizkun) dhe mos e ngarko veten...

## **POPULLARITETI**

Sa e sa të popullarizuar në tokë janë të panjohur në qiell,  
e sa e sa të panjohur në tokë janë të njohur dhe eminentë në qiell.

## **BLETA DHE LAVDRUESIT**

- Bleta i viziton 50 000 lule për të prodhuar pak mjaltë.
- Disa mendojnë se me pak fjalë, me disa vargje poezie dhe pa vepra, t'i prodhojnë 50 000 lëvdata për veten e tyre.

## **ZHVESHJA E BESIMIT**

Besimi ynë ka filluar të zhvishet, sikurse kur zhvishet pema nga gjethet e saj në sezonin vjeshtor.

Orientimi ynë tek Allahu ka mbetur vetëm si formalitet prej formaliteteve.

Ky formalitet në mesin tonë është rezultat i pozitës në të cilën gjendet bota islame, si individualisht ashtu edhe si shoqëri.

## **FURNIZUESI DHE I FURNIZUARI**

Një njeri shkon në luftë në rrugën e Allahut.

Në shtëpi e lë bashkëshorten me fëmijë.

Disa prej grave, të cilat e kishin imanin e dobët, i thonë:

“Oj nënë e gjoë, po kush do të përkujdeset për familjen dhe t’i ushqejë fëmijët nëse Allahu e ka caktuar të bjerë dëshmor?”

Gruaja besimtare, me bindje dhe iman të fortë, u thotë:

“Unë burrin tim e di se ka qenë i përkujdesur dhe i ushqyer; ndërsa nuk e di se ka qenë ushqyes apo përkujdesës. E nëse vdes i ushqyeri, mbetet ushqyesi – Furnizuesi (Allahu i Lartëmadhëruar).”

## **SPROVAT E JUSUFIT**

Jusufi a.s. është provuar me vështirësi ekonomike, por pastaj ai u bë nga njerëzit më të pasur të Egjiptit, drejtues i ekonomisë shtetërore.

**KAPITULLI SHTATË:**  
**SHEJTANI**

## **ARMA E SHEJTANIT**

Arma më e fuqishme e shejtanit për ta luftuar njeriun është frikësimi me varfëri.

Pasi të hyjë në zemrën e njeriut frika se mund të varfërohet, atëherë:

- e mohon të drejtën;

- flet sipas epshit (dëshirave – nuk e flet të vërtetën).

## **SHEJTANI URDHËRON PËR IMORALITET**

**“Shejtani ju frikëson me varfëri dhe ju urdhëron për imoralitet, ndërsa Allahu ju premtan se do t’ua falë gabimet tuaja dhe do t’ju sigurojë të mira dhe begati.**

**Allahu është Dhuruesi i të mirave të mëdha. Ai është i Dituri gjithpërfshirës.” (El-Bekare, 268)**

## **SHEJTANI**

Allahu na ka përgatitur se si mund ta largojmë shejtanin.

Shejtani angazhohet në dy çështje:

E para: ideja të cilën e ka plasuar shejtani është për çështje të kësaj bote; atëherë krahaso

çështjet e botës tënde dhe

qëndrimin tënd para Zotit tënd.

Besimtari nuk i jep përparësi çështjeve të tij të kësaj bote duke qëndruar para Zotit të tij.

Kur shejtani e kupton këtë, kalon në çështje tjetër.

Shejtani ka thënë: **“Do të ulem pranë tyre, në rrugën Tënde të drejtë...”**

E ka ditur fushëveprimtarinë e tij,

e ka ditur pozitën e tij.

## **SHEJTANI HAJDUT**

Shejtani është sikur hajdut.

Hajduti asnjëherë nuk shkon te shtëpia “e prishur”, por hajduti shkon te shtëpia e mirë.

Kur pronari i shtëpisë së mirë ulet pranë dritares dhe e sheh hajdutin dhe anohet nga dritarja, që nënkupton se e ka kuptuar se hajduti gjendet në shtëpi, hajduti e kupton se pronari i shtëpisë e ka hetuar; atëherë,

çfarë qëndrimi merr hajduti?

Atëherë hajduti ikën dhe largohet nga ajo shtëpi e mirë.

## **MËKATI I PARË I SHEJTANIT**

Mëkati i parë ndodhi në qiell, ku Iblisi refuzoi përuljen ndaj Ademit (a.s.), e gjitha kjo nga zilia.

## **ANËT NGA TË CILAT SULMON SHEJTANI**

Anët nga të cilat shejtani i shkon njeriut janë:

- nga pjesa e parme,
- nga pjesa e pasme,
- nga ana e djathtë,
- nga ana e majtë.

Anët nga të cilat nuk i shkon njeriut shejtani janë:

- nga ana e poshtme dhe
- nga ana e lartë.

Shihet se në katër anë shejtani tenton t'i shkojë njeriut, ndërsa në dy anë të njeriut nuk mund t'i shkojë, ato janë:

- ana e poshtme e njeriut;
- ana e lartë e njeriut.

Ana e poshtme është ana ku njeriu i bie në sexhde Krijuesit.

Ana e lartë është ana ku njeriu i lutet Krijuesit.

- Pra, sexhdeja ndaj Zotit e largon shejtanin nga njeriu.
- Lutja dhe përkujtimi ndaj Zotit e largojnë shejtanin nga njeriu.

## **SULMET E SHEJTANIT**

Shejtani e sulmon njeriun:

- nëse nuk arrin të ketë sukses me sulm, ai i përgatit kurthe;
- nëse e sheh se njeriu nuk bie në kurthet e tij, fillon ta mashtrojë;
- nëse nuk mundet ashtu, tenton ta frikësojë;
- nëse nuk mundet ashtu, fillon ta vë në dyshime;
- nëse nuk mundet ashtu, veprat e këqija ia zbukuron, kinse janë vepra të mira;
- nëse nuk mundet ashtu, fillon t'i paraqitet njeriut se është një këshilltar i mirë e i sigurtë dhe se ia do të mirën njeriut, por, përkundrazi, shejtani qëllimin kryesor e ka që njeriun ta bëjë pabesimtar dhe të digjet në zjarr së bashku me të.

## **SHEJTANI DHE EJUBI A.S.**

Shejtani, i cili ishte prej xhinëve, shkon te Ejubi a.s. dhe i thotë:

**“Po të të kishte dashur Zoti, nuk do të të kishte sprovuar me këto sprova.”**

Ejubi a.s. i përgjigjet:

**“Largohu, o i mallkuar, se Zoti më ka dhënë atë e cila është më e vlefshme se çdo gjë:**

**- zemrën, e cila ka bindje të thellë dhe nuk e harron kurrë Zotin, dhe**

**- gjuhën për ta përmendur Zotin.”**

## **SHEJTANI DHE JAKUBI**

Jakubi a.s. e ka këshilluar djalin e tij Jusufin duke i thënë:

**“Shejtani për njeriun është armik i qartë.”**

## **NAIVITETI**

Kur është pyetur një njeri i çmendur, i cili nuk fliste shumë dhe nuk i përgojonte të tjerët:

“Çka mendon për Iblisin (shejtanin)?”

Ai është përgjigjur:

“Për të kam dëgjuar fjalë shumë, e të fshehtë e tij e di Allahu më së miri.”

## **IBLISI DHE ISAU A.S.**

Tregohet se, përderisa një ditë Isa a.s. qëndronte në një kep, i shkon shejtani e i thotë:

“A nuk thoni se kur Allahu dëshiron që dikush të vdesë, ai patjetër duhet të vdesë?”

I thotë: “Po. Përndryshe nuk vdes.”

Atëherë Iblisi, qoftë i mallkuar, i thotë Isaut a.s.:

“Atëherë, hidhu prej këtij kepi dhe shiko: nëse Allahu ka caktuar të vdesësh, do të vdesësh, e nëse jo, nuk do të vdesësh.”

Isa a.s. i thotë:

“Mbylle gojën, o i mallkuar, se Allahu është Ai i Cili i vë në sprovë njerëzit, e nuk është që njerëzit ta vënë në sprovë Zotin e tyre.”

**KAPITULLI:**  
**JETA DHE VDEKJA**

## **NDËRRIMI I ORËS DHE JETËS**

- E kundërta e jetës është vdekja, sikurse
- E kundërta e vdekjes është jeta.

Mirëpo, të mos harrojmë se ndërrimi i vdekjes në jetë dhe i jetës në vdekje nuk është sikurse ndërrimi i orës.

## **JETA DHE VDEKJA**

“Pse ty të besojnë dhe të duan, ndërsa mua nuk më duan?”  
- i thotë VDEKJA JETËS.

“Ngase unë jam mashtruese dhe gënjeshtare, ndërsa ti je realiteti dhe e vërteta” – i përgjigjet JETA VDEKJES.

## **KJO BOTË DHE BOTA TJETËR**

- Në këtë botë jemi në banesë me qira, ndërsa
- Në botën tjetër jemi në banesën e pronësisë sonë.

Në banesën me qira investo vetëm në çështje dytësore, ndërsa në banesën e pronësisë investo në çështje themelore.

## **KJO BOTË DHE XHENETI**

- Kjo botë është e lirë: e posedon i pasuri dhe i varfëri, mbreti, kryeministri dhe ministri.

- Xhenneti është i shtrenjtë; e fiton vetëm vepra jote e mirë, nuk mund ta pronësosh me pasurinë tënde.

## **KJO BOTË DHE BOTA TJETËR**

- Këtë botë, Allahu ia jep atij të cilin e do dhe atij të cilin nuk e do.

- Botën tjetër, Allahu ia jep vetëm atij të cilin e do.

## **KOHA MË E MIRA E JETËS**

Një njeri u pyet për kohën më të mirë të jetës së tij:

- Koha më e mirë e jetës sime ishte koha e nëntë muajve në barkun e nënës sime, ku i kisha të siguruara të gjitha: pije, ushqim dhe gjithçka.

- Pas asaj kohe, kurrë më në jetën time nuk kam pasur qetësi.

## **STINËT E JETËS**

Jeta kalon nëpër katër stinë të vitit: verë, vjeshtë, dimër dhe pranverë.

- Lapsi i jetës ka për të kaluar nëpër këto stinë, andaj bëhu ashtu që kur ngjyra e lapsit të jetës të harxhohet, të mbesin shkrimet (gjurmët) e bukura në pranverë prej tij.

## **JETA DHE VDEKJA**

- Ndërroi jetë aty ku dhe kur s'e priti askush, ndërsa ai kishte menduar se çastin e vdekjes do ta përcaktonte vetë, ashtu siç e kishte përcaktuar vendin dhe kohën e dasmës së tij.

## **FATKEQËSIA**

- Vdekja nuk është fatkeqësia më e madhe e jetës, pasi është ligj i jetës.

- Fatkeqësia më e madhe e jetës është që, deri sa je i gjallë, të të vdesë frika ndaj Allahut në zemrën tënde.

## **KJO BOTË**

- Kjo botë (njerëzit e kësaj bote) e ka vlerësuar me çmim të lirë Jusufin a.s.

- Kjo botë e ka hedhur në zjarr Ibrahimin a.s.

- Kjo botë e ka akuzuar për magjistarë Musain a.s.

- Kjo botë e ka përgënjeshtuar Nuhun a.s.

- Kjo botë e ka gjuajtur me gurë Muhamedin a.s.

Pse të mendosh se njerëzit e kësaj bote nuk mundohen të zhvlerësojnë, akuzojnë apo dëmtojnë ty?

## **MËSIMI DHE PROVIMI**

- Në fakultetin e universitetit, në rend të parë mëson pastaj hyn në provim.

- Në fakultetin e jetës, në rend të parë hyn në provim pastaj mëson.

## **INTERESANT**

- Njerëzit qajnë kur trupit i vdes, por shpesh harrojnë se vdekja e zemrës është më e rrezikshme se vdekja e trupit.
- Muslimani e di se ka lindur për të vdekur dhe kur të vdes, shkon te Zoti i Lartëmadhëruar, takohet me pejgamberët dhe shkon në xhennet.
- Muslimani nuk duhet të frikësohet nga vdekja.

## **KUSH ÇKA DËSHIRON I REALIZOHET!?**

- **Kush dëshiron shpërblimin e kësaj bote dhe të botës tjetër, shpërblimi është tek Allahu. (Nisa, 134)**
- **Kush dëshiron jetën e kësaj bote, Ne do t'u plotësojmë shpërblimin e veprave të tyre në të. (Hud, 15)**
- **Kush dëshiron vetëm këtë botë, Ne ia japim aq sa duam dhe pastaj ai hyn në Xhehennem. (Isra, 18)**
- **Kush dëshiron krenarinë, e gjithë krenaria i takon Allahut. (Fatir, 10)**
- **Kush dëshiron fitimin e botës tjetër, Ne do t'ia shtojmë fitimin. Kush dëshiron vetëm këtë botë, Ne ia japim, por në botën tjetër nuk ka hise. (Shura, 20)**

## **ISLAMI NUK ËSHTË RRUGË TRANSITE**

- Jeta në këtë botë është rrugë transite për të shkuar në botën tjetër.

- Islami nuk është rrugë transite për të realizuar ndonjë përfitim dhe, nëse nuk e realizon atë përfitim, largohet nga rruga e xhenetit.

Zoti thotë:

**“Ka disa njerëz që e adhurojnë Allahun për përfitime:**

**- nëse përfitojnë ndonjë interes, janë të kënaqur,**

**- nëse i godet fatkeqësia, kthehen në pabesim dhe humbasin këtë botë dhe botën tjetër.”** (El-Haxh, 11)

## **PROCESI I VDEKJES**

- Fillon nga këmbët: që të mos ikësh nga dhimbjet dhe vuajtjet.

- Përfundon te syri: që të shohësh çdo gjë që ndodh rreth teje.

## **MOS VEPRO PËR EMËR**

- Kur të vdesësh, çështja e parë që bie nga ti është EMRI.
- Nuk të thërrasin me emër gjatë faljes së xhenazes apo vendosjes në varr.
- Andaj, mos vepro për emër.

## **ËSHTË PËR T'U HABITUR**

- Më shumë brengosen për dukurinë e vdekjes, se sa për pasvdekjen.

## **PËR TË VDEKURIN**

- Tërë jetën ke vrapuar për pasuri, ushqim, veshmbathje dhe vendstrehim.
- Pas vdekjes, as ushqimi, as rrobat, as pallatet më të mira nuk mund t'i përdorësh.
- Ekziston vetëm një pallat: varri.
- Procesi i larjes dhe përgatitjes për varrim kryhet pa mundësi për të thënë "jo". Nuk mund të flasësh, të ulesh apo të qëndrosh në këmbë.

## **VDEKJA E PYET JETËN**

- Vdekja pyet jetën: “Pse ty të duan kaq shumë, ndërsa mua më urrejnë?”
- Jeta përgjigjet: “Sepse unë jam një gënjeshtër e bukur, kurse ti një e vërtetë e hidhur.”

## **VARRI DHE PARABURGIMI**

- Kemi dy lloje paraburgimesh: për këtë botë dhe për botën tjetër.
- Varri është vendbanim dhe vendqëndrim, një parajetësë e jetës së përjetshme, i ngjashëm me paraburgimin; më pas vjen gjykimi – për Xhehenem ose për Xhennet.

## **KAPITULLI I TETË:**

### **NËNA**

## **NËNA**

Nëna është ushqim (shpirtërorë) kur je i uritur;

Nëna është shërim kur je i sëmurë;

Nëna është festë kur je i gëzuar;

Nëna është shtrat kur je duke fjetur;

Nëna është lutje për ty kur ti e harron lutjen.

Atëherë, pse nuk po bëhesh i mirë me nënën tënde!?

## **NËNA**

- Kur nuk ke mundur të ushqehesh, të ka ushqyer në barkun e saj.

- Kur nuk ke mundur të marrësh frymë, të ka dhënë frymëmarrje në barkun e saj.

- Kur nuk ke mundur të pish ujë, të ka dhënë ujë në barkun e saj.

- Kur nuk ke mundur të ecësh – e të mos flasim të vraposh pas topit – të ka bartur duke ecur me mundime në barkun e saj.

## **NËNA**

Kur i është parashtruar pyetja Pejgamberit a.s. (ashtu siç i parashtrojnë pyetjet gazetarët pas ndeshjeve):

- Kush meriton dashurinë më të madhe?
- NËNA
- Kush meriton dashurinë më të madhe?
- NËNA
- Kush meriton dashurinë më të madhe?
- NËNA

## **LUTJE PËR NËNËN**

Zoti im,

- Bëje nënën time zonjë prej zonjave të xhenetit.
- Zbardhe fytyrën e nënës time në ditën kur disa fytyra do të zbardhen e disa të tjera do të jenë të zeza.
- Vendose në hijen Tënde në ditën kur nuk do të ketë hije përpos hijes Tënde.
- Mëshiroje nënën time dhe bëje që të pi ujë të kevtherit në xhenet.

## **MOS E NGRIT ZËRIN NDAJ NËNËS**

Mos e ngrit zërin ndaj asaj e cila të ka mësuar të flasësh.

Zoti im,

- Bëje nënën time të jetë e kënaqur me mua.
- Më mundëso që t'i dhuroj mirësi dhe lumturi nënës sime.
- Mos më privo nga mirësitë për të.
- Zëri i saj le të jetë aromë shtëpie dhe fjala e saj le të dëgjohet gjithmonë në shtëpi.

## **KUJDESI NDAJ NËNËS**

Zejnul Abidin el Husejni ishte njëri i cili më së shumti kujdesej për nënën e vet.

I kanë thënë: “Ne të njohim se je njeri më i kujdesshëm ndaj nënës tënde, por kurrë nuk të kemi parë duke ngrënë së bashku me të (në një sofër me të).”

Ka thënë: “Frikohem se ndoshta syri i saj e ka parë ndonjë pjesë të ushqimit dhe e ka pas ndërmend ta marrë, ndërsa dora ime e merr para saj – pa e ditur – do të isha i pakujdesshëm ndaj saj.”

## **EDUKIMI**

I kishte vdekur burri.

Pallton e burrit të saj e kishte varur në dollap.

Të hollat i vendoste në xhepin e palltos së burrit të saj.

Kur ndonjëri nga fëmijët e saj i kërkonte të holla për të shpenzuar, i thoshte: “Shko merr te xhepi i palltos së babës!”

Kështu vepronte që të mos harrohej përmendja e BABË-s në shtëpi.

Të mos harrojmë se NËNA është shkollë speciale në vete.

## **ZEMRA E NËNËS**

Një tabiin ishte sëmurë.

Nëna i shkon për vizitë.

Ai me shpejtësi u vesh dhe u rregullua thua se nuk kishte kurrfarë dhembje.

Pasi ka shkuar nëna e tij, ai është alivanosë.

- Deri sa qëndroi ajo, ishte i shëndoshë, çka ndodhi tani me ju? - e kanë pyetur.

- Dhembjet e fëmijëve i lëndojnë zemrat e nënave – është përgjigj.

## **CILIN FËMIJË E DO MË SË SHUMTI**

Kur e kanë pyetur një nënë: “Cilin fëmijë e do më së shumti?”

Ajo është përgjigjur: “Më së shumti e dua:

- të voglin derisa të rritet;
- atë i cili zhduket derisa të kthehet;
- atë i cili sëmuret derisa të shërohet.”

## **NËNA DHE CIVILIZIMI**

Sot kemi një nënë e cila me vështirësi, me mund, me sakrificë dhe në kushte të vështira të okupimit ka rritur fëmijët, ku përpos që nuk ka bërë gjumë për përkujdesje të fëmijës (fëmijëve), nuk i ka kënaqur barkun me qëllimin e vetëm që kafshatën e fundit ta rezervojë për fëmijën.

Ndërsa më pas fëmijët e asaj nënë e kanë marrë rrugën e “civilizimit”, ku fëmijët e kanë idol artistin i cili shkurorëzohet çdo vit, ose artistin i cili nuk martohet kurrë, ose edhe të martuarit me gjini të njëjtë.

E, në fund, ajo nënë përfundon: jo në shtëpi të pleqve, por në “burgje” të pleqve.

**KAPITULLI I NËNTË:**

**SHKËNDIJA TË PERSONAZHEVE  
KUR'ANORE**

## **DEBATI**

Zoti i Madhërishëm thotë: “Kul tealev” (Eja lartë), ndërsa ne zbresim poshtë.

Ne zbresim poshtë dhe debatojmë:

- me gjuhën e të tjerëve
- me traditat e të tjerëve
- me iniciativat e të tjerëve
- me angazhimet e të tjerëve
- në realizimin e qëllimeve të të tjerëve.

## **TREGIMI MË I BUKUR**

Sureja Jusuf është historia më e mirë, sepse është shpresëdhënëse pas dhimbjes, në të cilën:

- fitoi i shtypuri
- u lirua i burgosuri
- u dëshmuar pafajësia
- u gëzuar i pikëlluari
- u larguar vështirësitë
- arriti lajmëmiri
- u shëruar i verbëri
- pranoi fajësinë e padrejta
- kërkuan falje gabimtarët
- u kthye i largëti
- u realizuar ëndrra.

Prandaj ke besim tek Allahu dhe mos e humb shpresën në mëshirën e Tij.

## **SURETU JUSUF**

Suretu Jusuf është historia më e mira e të gjitha kohëve, nga shkakut se fillon me ëndrrën dhe përfundon me realizimin e ëndrrës.

Kjo nënkupton se Allahu dëshiron të na thotë të mos heqim dorë në realizimin e ëndrrave tona, të cilat të tjerët mundohen të na i ndërpresin.

## **VONIMI I REALIZIMIT TË DËSHIRËS**

Jusufi a.s. ishte në burg së bashku me dy shokë.

Jusufi ishte më zemërmirë se shokët e tij, mirëpo përkundër kësaj dy shokët e tij dolën më herët nga burgu, ndërsa Jusufi mbeti në burg edhe për disa vite.

- I pari: Ka dalë nga burgu për t'u bërë shërbëtor.
- I dyti: Ka dalë nga burgu për t'u vrarë.
- Jusufi a.s.: Ka dalë nga burgu me vonesë për t'u bërë ministër i financave.

Ndonjëherë vonohet realizimi i ndonjë dëshire me qëllim që të ketë të mira të shumta.

## **PERSONAZHET E SURETU JUSUF**

Historia e Jusufit konsiderohet si historia më e bukur në Kur'an, sepse të gjithë personazhet aty përfundojnë mirë:

- Gruaja e ministrit dhe gratë e tjera që deshën t'i bëjnë keq u penduan.
- Bashkëvuajtësi në burg doli nga burgu dhe filloi punën që kishte më parë.
- Mbreti i Egjiptit mbajti fronin dhe ruajti popullin e tij nga uria.
- Lindja e Mesme shpëtoi nga kriza ekonomike falë zgjuarsisë së Jusufit a.s.
- Vëllezërit e tij u penduan për atë çfarë kishin bërë babait të tij, Jakubit a.s., dhe iu bashkua e gjithë familja.

Jusufi a.s. doli me sukses nga të gjitha situatat e vështira. Historia e suretu Jusuf flet për suksesin e arritur pas sprovave.

## **SPROVAT E JUSUFIT A.S.**

Sprovat e Jusufit a.s. janë:

- Sprova nga urrejtja dhe xhelozia e vëllezërve të tij.
- Sprova nga ndarja nga familja.
- Sprova nga hedhja e tij në një pus të thellë me synim që të vdiste.
- Sprova e shitjes si rob.
- Sprova e ekspozimit ndaj joshjes së gruas së ministrit dhe më pas u akuzua me nderin e tij duke u futur në burg.

## **JUSUFI NË BURG DHE MINISTËR**

Në burg i thanë: “Ne të shohim nga bamirësit.”

Kur ishte në fron dhe kërkonin falje, të shikonin nga bamirësit.

## **JUSUFI**

Jusufin synuan ta mbysin, por nuk vdiq.

Synuan t'ia humbin rrugën, por u lartësua – u ngrit;

E shitën për rob, por u bë mbret;

Tantuan ta largojnë nga dashuria e babait, por ajo vetëm sa u shtua.

Andaj, mos ke dert për çfarë planesh bëjnë njerëzit, ngase vullneti i Allahut është mbi çdo gjë.

## **MUSAI A.S. DHE DETI**

Musai a.s. ishte foshnjë dhe nuk mund të ecte, kështu që u vendos në sënduk uji dhe u bart deri te pallati i Firaunit.

Pastaj, kur Musai a.s. nuk ishte më foshnjë, deti u nda në dysh që të ecte nën shkëmbinjtë e tij dhe deti ta përmbyste Firaunin me ushtrinë e tij.

## **FIRAUNI DHE MUSAU**

- Në ujë është fundosur Firauni me ushtrinë e tij të fortë.

- Në ujë nuk është fundosur Musai a.s. si foshnjë në sëndukun e tij.

## **ZELHAJA DHE VAJZA E SHUAJBIT**

Joshja e Zelihajas nuk e arriti qëllimin për të mashtruar dhe bërë për vete Jusufin a.s., ndërsa edukata e vajzës së Shuajbit bëri që ajo të martohej me Musain a.s.

## **FTESA E NUHUT**

Nuhu a.s. njëherë i ka thirrur kafshët, dhe të gjitha menjëherë i janë përgjigjur thirrjes së tij dhe kanë hipur në anije për të shpëtuar.

Ndërsa, Nuhu a.s., përgjatë 950 viteve pandërprerë, ka thirrur njerëzimin dhe nuk e kanë dëgjuar përpos një numri të vogël.

Kjo tregon se: më e mirë është intuita e shëndoshë se sa mendjet dhe zemrat e sëmura të shumë njerëzve.

## **ISMAILI ME DJALIN E NUHUT**

Ibrahimi a.s. i thotë Ismailit: Jep jetën për rrugën e drejtë.

Djali e dëgjon dhe shpëton nga vdekja.

- Nuhu i thotë djalit: “Mos vdis në rrugë të shtrembër, eja jeto në rrugë të drejtë.”

Djali nuk e dëgjon dhe mbytet.

## **KARUNI DHE FIRAUNI**

Karuni fundoset në tokë (e përbinte toka) dhe, edhe pse ishte duke e parë veten duke u fundosur, nuk e përkujtonte Zotin dhe u fundos me pasurinë e tij.

Firauni u ngrit mbi det dhe atëherë u kujtua dhe para fundosjes e përkujtoi Zotin, por ai përkujtim ndaj Zotit nuk iu pranua dhe e përmbyti deti.

## **KONFIRMIMI I LAJMIT ËSHTË PROGRAM I PEJGAMBERËVE**

Hud-Hudi ka qenë i përpiktë në transmetimin e lajmit (informacionit), për këtë arsye nuk ka thënë: “Kam dëgjuar”, por ka thënë: “Kam prezantuar, e kam parë dhe kam sjellë te ti një lajm të sigurt nga vendi i Sebeit.”

Edhe Sulejmani nuk ka nxituar siç nxitojmë ne. Edhe pse e ka ditur se Hud-Hudi nuk ka gënjyer, ka thënë: “Do të shohim, do ta konfirmojmë se a e thua të vërtetën apo je nga gënjeshtarët!”

Konfirmimi i lajmit është kërkesë fetare, program i pejgamberëve; andaj mos e shpërndaj një lajm të cilin nuk e di se a është i vërtetë apo jo.

## **MUSAU DHE HIDRI**

Ndoshta fëmijët kanë qenë duke fjetur, duke u zbavitur, ose duke luajtur, por Hidri me Musaun e kanë riparuar murin për ta ruajtur pasurinë e atyre fëmijëve.

Ushtarët e gjithëmëshirshëm veprojnë për të siguruar jetën tuaj.

## **MENDO POZITIVISHT**

Ibrahimi a.s. mendoi se mungesa e pasardhësve do të ishte fundi i tij, por nuk ndodhi ashtu.

Allahu e begatoi me Ismailin dhe Is'hakun.

Allahu e bëri baba të shumë kombeve.

Pasardhësit e tij u shtuan si yjet e qiellit.

Ibrahimi a.s. përmendet te të gjitha fetë qiellore.

Jusufi a.s. mendoi se burgu ishte fundi i rrugës së tij, por nuk ndodhi ashtu.

Allahu e ngriti në pozitë të lartë dhe e bëri sundues në tokën e Egjiptit.

Davudi a.s. mendoi se do të vdiste nga dora e Talutit, por nuk ndodhi ashtu.

Allahu e shpëtoi, e forcoi dhe e bëri mbret e pejgamber në tokën e tij.

## **MALLKIMI PËR IBLISIN**

Iblisi, kur ka thënë: “Unë jam më i mirë se ai”,

Allahu e ka mallkuar dhe e ka dëbuar nga mëshira e Tij.

## **MOSDËGJIMI I BABAIT**

Djali i Nuhut, kur ka thënë: “Unë do të ngjitem në maje të malit ku do të sigurohem”,

Allahu e ka përmbytë.

## **ARROGANCA**

Nemrudi, kur ka thënë: “Unë bëj që të jetojnë dhe që të vdesin njerëzit”.

Allahu e ka shkatërruar.

## **KRIMINELI**

Firauni, kur ka thënë: “Unë jam Zoti më i madhi”,

Allahu e ka përmbytë.

## **VETPËLQIMI**

Karuni, kur ka thënë: “Unë këtë (pasuri) e kam arritur me diturinë time”,

E ka përpirë toka.

## **KAPITULLI I DHJETË:**

### **LAICIZMI**

## **Laicizmi**

- Respekton të gjitha fetë pos Islamit;
- Respekton të gjitha gjuhët pos gjuhës arabe;
- Respekton të gjitha mendimet përpos fetvave;
- Respekton të gjitha veshjet pos Hixhabit;
- I do të gjitha vendet pos xhamive.

## **DUNJAJA DHE FEJA**

“Dunjaja është bahçe e ahiretit.

Kjo fe nuk mund të kompletohet pa dunjanë.”

## **QEVERISJA DHE FEJA**

Qeverisja dhe feja janë binek.

Feja është bazë.

Qeveritarët janë sigurues.

Çdo gjë që nuk ka bazë është e caktuar për shkatërrim.

Çdo gjë që nuk ka sigurues është e caktuar të humbë.

## **DHUNA**

Nuk është e çuditshme kur dëgjojmë se:

- Ideja e ndalimit të kamatës është ide e dhunshme sepse pengon zhvillimin ekonomik.
- Ideja e ndalimit të prostitucionit është e dhunshme sepse pengon lirinë e të drejtës së njeriut.
- Ideja e të marrurit të fesë me politikë është e dhunshme sepse ndikon që feja të marrë qeverisjen shtetërore. Po ashtu,

Nuk duhet të çuditemi kur do të dëgjojmë se:

- Thirrja e ezanit është ton i dhunshëm.
- Falja e namazit është veprim i dhunshëm.
- Deklarimi i shehadetit është deklarim i dhunshëm.
- Zekati është i dhunshëm sepse selekton personat të cilët e meritojnë zekatin dhe personat të cilët nuk e meritojnë.
- Agjërimi është veprim i dhunshëm sepse e mundon trupin dhe është në kundërshtim me lirinë e trupit.

## **E DI AI!**

E di ai!

E pengon ezanin,

dhe prapë thotë nuk jam Islamofob!?

E di ai!

E pengon xhaminë përgjatë rrugëve kryesore,

dhe prapë thotë nuk jam Islamofob!

E di ai!

E pengon xhaminë përgjatë rrugëve dytësore,

dhe prapë thotë nuk jam Islamofob!

E di ai!

E pengon xhaminë nëpër fshatra të thella ku ka shumë pak banorë,

dhe prapë thotë nuk jam Islamofob!

E di ai!

E pengon përshëndetjen islame “Esselamu alejkum” (Paqja qoftë mbi ju),

dhe prapë thotë nuk jam Islamofob!

E di ai!

E pengon shprehjen e mirëseardhjes “Merhaba”,  
dhe prapë thotë nuk jam Islamofob!

E di ai!

E pengon veshjen islame,  
dhe prapë thotë nuk jam Islamofob!

## **NUK E DI**

- Nuk e di çka është feja e çka është kombi.
- Nuk e di çka është akideja (Akaidi) e çka është sheriati.
- Nuk e di çka është sekti e çka është medhhebi.
- Nuk e di çka është traditë fetare e çka është traditë jofetare.

Pastaj thotë: DI!?

## **TERMINOLOGJITË**

Terminologjitë islame i quajnë bastardim të gjuhës shqipe, ndërsa terminologjitë e tjerëve i quajnë pasurim të gjuhës shqipe. Për këtë arsye edhe nuk e quajnë ABC(D)-ja e gjuhës shqipe, por ALFA-BETI (“ALFA” shkronja e parë e gjuhës greke dhe “BETA” shkronja e dytë e gjuhës greke) i gjuhës shqipe.

## **SHOPINGU ME RASTIN E ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE**

DJE:

- Ku po shkon?
- Te blej diçka.
- Blej edhe për mua.
- Në rregull, do të blej edhe për ty.

SOT:

- Ku po shkon?
- Në shopping.
- Shoppinge edhe për mua.
- Në rregull, do ta shoppingi edhe për ty.

## **E PENGON**

E pengon termi “Islami Politik” dhe merret vet me politikë, dhe prapë thotë nuk jam Islamofob!

Ai thotë: Jam properëndimor, por edhe feja e Perëndimit burimin e ka nga Lindja. Pra, properëndimor mund të jesh edhe me fenë e Lindjes (nga Lindja).

Ai nuk është vetëm islamofob, por është edhe egofob (frikë nga vetvetja). Ai frikësohet nga çdo gjë. Ai frikësohet edhe nga hija e tij.

## **QENTË ENDACAK**

Gjatë një viti, vetëm në Prishtinë, të kafshuar nga qentë endacak 511 persona. Ndoshta janë pak, sepse kafshimi i tyre është e drejtë e tyre!!!

## **MBLEDHJA!**

Sot, me datën ....., u mbajt mbledhja me të mbledhurit.

Tema e Mbledhjes: Mbledhja.

Të gjithë diskutuan rreth mbledhjes.

Asnjëri nuk e kundërshtoi mbledhjen për të biseduar për mbledhje.

Në pushimin e mbledhjes u mbledhën për një koktej.

Pas mbledhjes u mbledhën për të ngrënë darkën e mbledhjes.

Po ashtu, pas mbledhjes morën meditime të mbledhjes.

Në mbledhje kishte karrika dhe karrierista.

Në mbledhje kishte edhe ujë.

Në fund u vendos të mbledhen, por vetëm për t'u mbledhur dhe për asgjë tjetër.

Në mbledhje më së shumti u mbledh humbja e kohës. Kjo, ngase vendimet merren jashtë mbledhjes dhe atë para mbledhjes, ashtu që mbledhja, edhe po të mos mbahej, vendimet e mbledhjes do të ekzekutoheshin edhe pa u mbledhur.

## **POZITA**

Sot, kur ndonjëri ngritet në pozitë, nuk “prek për tokë”,

- nuk e njeh as vetveten.
- E kritikon fenë e vet.
- I kritikon traditat e popullit të vet.
- E kritikon vendin e vet.
- E kritikon mënyrën e jetesës së vendit të vet.
- E kritikon edhe gjuhën e vet.

## **KLASA E RE POLITIKE**

Na duhet një klasë e re politike.

Pse?

Që të jenë robër (skllav) të klasës së vjetër politike!!!

## **PARTIA**

E pyet shokun:

Çka do të thotë Parti?

Shoku përgjigjet:

Parti do të thotë me i vendosë: Ujkun, Dhinë dhe Lakrën në një varkë dhe pastaj varka të lundrojë në det.

## **RAPORTIMET E GAZETARIT**

Raportimet dhe hulumtimi i gazetarit.

Gazetari raportoi se djali e preu babën me sopatë.

Gazetari nuk hulumtoi se politika e xhamisë nuk është vetëm vendosja e ballit në sexhde, por respektimi ndaj babës është i vlefshëm si me vendosë ballin në sexhde.

Gazetari raportoi se vëllai e mbyti vëllanë dhe e djegi trupin e vëllait të tij për pasuri.

Gazetari nuk hulumtoi se ndihma e vëllait ndaj vëllait ka shpërblim sikurse të kontribuohet për ndërtimin e ndonjë xhamie.

Gazetari raportoi se djali e vrau babën dhe nënën dhe është zhdukur.

Gazetari nuk hulumtoi se politika e xhamisë është për t'i nderuar prindërit dhe se nën këmbët e tyre është begatia e kësaj bote dhe e botës tjetër.

Gazetari raportoi se vajza e vrau babën, nënën dhe dy vëllezërit dhe pastaj e mbyti vetën.

Gazetari nuk hulumtoi se politika e xhamisë është themelimi i familjes së shëndoshë.

Gazetari, nëse hulumton, e vërteton se:

- Politika e xhamisë është sigurimi i familjes, dhe nëse shkatërrohet familja, kanoset rreziku i shkatërrimit të lagjes.
- Politika e xhamisë është sigurimi i lagjes, sepse nëse shkatërrohet lagja, kanoset rreziku i shkatërrimit të qytetit.
- Politika e xhamisë është ruajtja e qytetit, sepse me shkatërrimin e qytetit kanoset rreziku i shtetit.
- Politika e xhamisë është sigurimi i shtetit, qytetit, lagjes, familjes dhe individit.

## **ÇKA KONSIDEROJNË PATRIOTIZËM**

Tek ne:

Patriotizëm konsiderohet kur individi i nënshtrohet sistemeve në dëm të çështjes kombëtare.

Ndërsa:

Patriotizëm konsiderohet kur individi i kundërshton sistemet nëse ndodh dëm në çështje kombëtare.

## **DITA E MËSUESIT**

Të jesh mësues për punimin e tokës, “nuk je mësues i mirë”, se i mëson të tjerët për të qenë BUJK, dhe profesioni i bujkut nuk është i mirë.

Të jesh mësues për rritjen e kafshëve shtëpiake, “nuk je mësues i mirë”, se i mëson të tjerët për të qenë blegtorë dhe nxënësin e quajnë Çoban, dhe profesioni i çobanit nuk është i mirë.

Të jesh mësues për të fituar botën tjetër, “nuk je mësues i mirë”, sepse nxënësit quhen fetarë dhe mbeten të prapambetur dhe shoqëria nuk zhvillohet.

Të jesh mësues për filozofinë ateiste dhe për mosbesimin në Zot, je mësues i mirë dhe bashkëkohor, dhe e zhvillon shoqërinë.

Në fund:

Urohet mësuesi me lule të plastikës të cilat nuk kanë as shije, as ngjyrë dhe as erë!!

## **“HAPUR” DHE “MBYLLUR”**

- Në të kaluarën:

Më këngë forcoheshin ndjenjat e patriotizmit.

- Tani:

Me këngë vyshken ndjenjat e patriotizmit.

- Sot:

Për të qenë patriot duhet të jesh “OPEN”.

Dasmat duhet organizuar “OPEN”.

Ahengjet duhet bërë “OPEN”.

Mbrëmjet e maturës duhet organizuar “OPEN”.

Ditëlindjet duhet organizuar “OPEN”.

Vetëm se:

- për edukim është “CLOSE”.

- për arsimim është “CLOSE”.

- për punësim është “CLOSE”.

- për zhvillim është “CLOSE”.

## **SHQETËSIMI DHE QETËSIMI**

Thotë:

- Jemi argëtuar në koncerte deri në orët e vona.

Pastaj pyet:

- Pse nuk më zë gjumi deri para mëngjesit?

Thotë:

- Kam qenë në aheng të dasmës me ambient të mbyllur dhe me muzikë të lartë.

Pastaj pyet:

- Kam dëgjuar zëra të çuditshëm në veshë deri para mëngjesit?

Thotë:

- Dëgjoj muzikë tallava, rep dhe këngë të tjera në kompjuter, telefon, etj.

Pastaj pyet:

- Pse nuk jam i qetë dhe ndihem i shqetësuar vazhdimisht?

Thotë:

- Gjatë gjithë natës jemi dëfryer dhe zbavitur.

Pastaj thotë:

- Pse ndihem i vetmuar dhe i lodhur gjatë gjithë ditës?

## **HESHTËT DHE FOLET**

- HESHTET para të mëdhenjve, ndërsa  
FLITET para të vegjëlve.
  
- HESHTET për çështje të rëndësishme, ndërsa  
FLITET për gjëra të parëndësishme.
- HESHTET kur mjeku të bën operacion, ndërsa  
FLITET për operacionin e shkatërrimit tënd.
  
- HESHTET për çështjet të cilat sjellin qetësi, ndërsa  
FLITET për çështje të cilat e trazojnë qetësinë tënde.
  
- HESHTET në restorante ku ushqehen të pasurit, ndërsa  
FLITET se pse nuk punojnë të varfërit.
  
- HESHTET kur ka qenë e nevojshme edukimi i fëmijëve,  
FLITET se pse fëmijët janë rritur dhe nuk janë edukuar.
  
- HESHTET gjatë intonimit të himnit, ndërsa  
FLITET derisa këndohet EZANI.

## **LAJMËRIM**

Oqeani i jetës është trazuar.

Dallgët e saj janë ngritur lartë.

Stuhia është e madhe.

Anija islame e shpëtimit është gati për nisje.

Për të hipur në anije nuk ju duhet të paguani biletë.

Nuk do të ketë kontroll të bagazhit.

Me vete e merrni vetëm besimin.

Destinacioni është i sigurt.

Hipni në të, mos hezitoni.

## **FUSHATA ELEKTORALE**

Besimtari tërë jetën bën fushatë elektorale, por jo për të zënë një vend në parlament, por për të zënë vend në xhennet.

## **SHPENZIMI I ENERGIJË**

- Shpenzohet energji për të këshilluar për durim ata të cilët durojnë ndaj torturave sikurse Bilalli; pastaj

nuk mbetet energji ndaj atyre të cilët janë torturues fiziko-psiqik, sikurse Umeje bin Halefi.

- Shpenzohet energji për këshillim ndaj atyre të cilët janë bujar si Othmani; pastaj

nuk mbetet energji ndaj atyre të cilët janë koprrac sikurse Karuni.

- Shpenzohet energji për këshillim për trimëri dhe guxim ndaj atyre të cilët kanë guxim, sikurse Omeri; pastaj

nuk mbetet energji ndaj atyre të cilët janë hipokrit, sikurse Abdullah bin Seluli.

- Shpenzohet energji për këshillim për sinqeritet te ata të cilët janë të sinqertë, sikurse Ebu Bekri; pastaj

nuk mbetet energji ndaj atyre të cilët janë sikurse Musejleme bin Kedhabi.

Shpenzohet energji në mes vete për t'u amortizuar para të tjerëve.

## **NGUSHËLLIMI**

Kanë vdekur, vdesin dhe do të vdesin njerëz të mirë. Lutemi për të gjithë që Allahu t'i shpërblejë me xhennet, t'i bashkojë me pejgamberët, me të mirët, me dashamirët e Allahut dhe me dëshmorët. Kur'ani fisnik na ka mësuar edhe lutjen për ta:

**“Rabbenaa ve ed’hil hum xhennati adininel-letii veadtehum ve men saleha min abaaihim ve ezvaxhihim ve dhurr-rrijaatihim”** (Gafir, 8)

**“O Zoti ynë, shpjeri ata në xhennetet e Adnit, të cilat ua ke premtuar,**

**- së bashku me të devotshmit prej prindërve të tyre,**

**- prej bashkëshorteve të tyre dhe**

**- prej pasardhësve të tyre!”** (Gafir, 8)

Mirëpo, sikurse edhe shumë terminologji, fraza dhe ide të cilat i ka mbjellë komunizmi, është fraza “ishte (është) i pazëvendësueshëm”, ndërsa Muhamedi a.s. na ka mësuar të themi:

***“O Zot, zëvendësoje (atë të vdekur në shoqëri) me më të mirë se ai”.***

Kjo, nga shkakut se shoqëria ka nevojë për njerëz të mirë dhe vdekja e të mirëve në shoqëri do të thotë se është humbur një pjesë e mirë e shoqërisë dhe nevojitet të zëvendësohet me njerëz të mirë, bile edhe me më të mirë dhe me më shumë të mirë.

## **PREMTIMET PARA ZGJEDHORE MOTI PËR MUAJIN NË VIJIM**

Në muajt në vijim do të ketë shi me premtime, re (mjegull) të dendura me fshehjen e së vërtetës, vende-vende me mashtrime.

Temperaturat më të larta gjatë muajve në vijim do të jenë me nxehtësi të fytyrës dhe me dhimbje koke, ndërsa temperaturat më të ulëta gjatë muajve në vijim do të jenë me vendosje të akullit në ballë.

E gjithë kjo do të përcillet me turma njerëzish për t'u proklamuar dhe për t'u fotografuar, ashtu që nxehtësia e motit (kohës) t'i djegë, ndërsa ftohtësia e motit (kohës) t'i flladisë.

## **APEL PËR NDIHMË**

Apel për ndihmë për Pasanik Mëkatarin.

Jeton me pasuri milionëshe dhe nuk i mjafton për të dy jetët.

Vuan nga sëmundja e lakmisë.

Gjendja shëndetësore varet nga aparati i zvogëlimit të lakmisë së tepërt.

I nevojiten sasi e konsideruar e këshillave fisnike.

Të gjithë ata që mundën të ndihmojnë mund ta bëjnë nëpërmjet xhirollogarisë së këshillave.

Operimi i tij nga sëmundja e lakmisë duhet të bëhet urgjentisht, përndryshe Pasanik Mëkatari atë pasuri nuk mund ta marrë me vete në botën tjetër.

Për ta bërë operimin i duhen urgjent këshilla të sinqerta dhe nga këshillues të sinqertë, sepse koha për këshilla sa vjen e shkurtohet, e avioni e pret për t'u nisur në botën tjetër, dhe në botën tjetër nuk i bën dobi pasuria materiale, por shërimi i zemrës nga këshillat, e që më pas zemra e shëndoshë i nevojitet për botën tjetër.

## **8 MARS**

Para Islamit, idhujtarët, të krishterët dhe jehudët i kanë shkelur të drejtat e grave, sa që idhujtarët i kanë varrosur fëmijët vajza për së gjalli.

Kjo ka ndodhur para 1400 viteve.

Para 100 viteve, kur në vendet krishtere (Evropë dhe Amerikë) janë ngritur gratë për të kërkuar të drejta më shumë, kjo sepse Evropa dhe Amerika kanë kaluar në shekularizëm.

1300 vite pas Islamit ka vazhduar shtypja e të drejtave të grave në krishterim, mirëpo me ndryshimin e rendit botëror, pra me shekularizmin, ka filluar ngritja e grave në revolucion për të kërkuar të drejta.

Shekularizmi nuk pajtohet edhe me të drejtat e grave të cilat janë në fenë islame. Ata dëshirojnë ta dëmtojnë fenë islame nga brenda (në familje).

Duhet ditur se 8 marsi nuk është ditë e nënave, por ditë e gjinisë femërore (grave në përgjithësi).

*Rregull: Çdo festë e cila nuk është festë adhurimi për diçka, por është manifestim normal dhe e cila nuk përzihet me haram, nëse fëmija e praktikon nuk do të thotë se ka dalë prej feje, por duhet t'i japim rëndësi rregullave islame në të gjitha çështjet.*

## **SHEMBULLI TIPIK I GRUAS SË MIRË**

Zoti Lartmadhëruar thotë:

**“E atyre që besuan, Allahu ilustron me një shembull: Gruan e Firaunit kur ajo tha: “Zoti im, më siguro një shtëpi pranë mëshirës sate në Xhennet dhe më shpëto prej Firaunit e brutalitetit të tij dhe më shpëto prej popullit mizor!” (Et-Tahrim, 11)**

- Gruaja e Firaunit (ASIJA) jetonte nën kurorën e burrit të saj pabesimtar, por kurrë nuk u pajtua me pabesimin e burrit të saj dhe kurrë nuk u pajtua me padrejtësitë e burrit të saj ndaj të tjerëve.

- Gruaja e Firaunit (ASIJA) e kishte jetën luksoze, por nuk e dëshironte jetën luksoze të kësaj bote dhe nuk dëshironte pasuri nëse ajo pasuri bëhej shkaktar për t'i humbur të mirat e botës tjetër.

- Gruaja e Firaunit (ASIJA) jetonte në një ndër shtëpitë më të mëdha të asaj kohe, por nuk i përbënte përshtypje shtëpia e madhe dhe luksoze, nëse nuk mund të kishte një shtëpi të saj, sa do të vogël, në Xhennet; iu lut Zotit: -“Zoti im, më siguro një shtëpi në Xhennet.”

## **DITA E FEMRËS, JO E NËNËS**

- Dita e nënës së njerëzimit në Islam është Dita e Hava-së.
- Dita e nënës në Islam është Dita e nënës së Musait a.s.
- Dita e motrës në Islam është Dita e motrës së Musait a.s.
- Dita e vajzës në Islam është Dita e vajzës së Shuajbit a.s.
- Dita e gruas në Islam është Dita e Asijës.
- Dita e femrës së pamartuar në Islam është Dita e Merjemës.
- Dita e nënës së besimtareve në Islam është Dita e Hatixhës r.a.

Kujtoni ditët dhe merrni mësim nga shembujt e këtyre heroinave të paharruara për gjithë njerëzimin.

## **BRENGAT**

Bregosen pse profesori në ditën e Xhuma shkon dhe falë namazin e Xhuma.

Bregosen pse mjeku në ditën e Xhuma shkon dhe falë namazin e Xhuma.

Bregosen pse punëtori në ditën e Xhuma shkon dhe falë namazin e Xhuma.

Bregosen pse zyrtari komunal në ditën e Xhuma shkon dhe falë namazin e Xhuma.

Bregosen pse bujku në ditën e Xhuma shkon dhe falë namazin e Xhuma.

## **KURIOZITET**

Nëse ti largohesh nga Allahu, tjetri do të afrohet tek Allahu. Allahu është i pavarur, Allahu s'ka nevojë për ju; ju keni nevojë për Allahun. Ndërsa, nëse i kthen shpinën Allahut, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, që nuk do të jetë si ju.

Allahu s'ka nevojë, e ju jeni të varfër (keni nevojë). Zoti i Madhërishëm thotë: **“Po nëse ju i ktheni shpinën, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, që nuk do të jetë si ju.”** (Muhamed)

## **FJALA “BEJ’Ë” NË KUPTIMIN E VOTIMIT**

Fjala “BEJ’Ë” ka kuptimin e këmbimit.

Fjala “BEJ’Ë” ka kuptimin këmbim vlerash.

Fjala “BEJ’Ë” ka kuptimin e këmbimit të mallrave; me fjalë tjera, shitblerje ku shitësi i merr të hollat, ndërsa blerësi e merr mallin.

Fjala “BEJ’Ë” mund ta ketë kuptimin e votimit dhe të pranimit.

Në të kaluarën muslimanët u kanë ndihmuar (dhe ende ndihmojnë) të varfërve.

Nëse u parashtrohet pyetja: pse u ndihmuan qytetarëve të varfër?

Përgjigja është: për ta rregulluar gjendjen materiale (në këtë botë) të qytetarit.

Nuk ka të keqe nëse dhuruesi kontribut-dhënës kërkon nga qytetari kontribut-marrës që ai të rregullojë gjendjen për veten dhe për familjen, edhe për këtë botë dhe për botën tjetër; me fjalë tjera, të jetë i devotshëm ndaj Krijuesit.

Kontributi material u jepet të varfërve jo vetëm për t'i shpëtuar në këtë botë, por për të fituar shpërblimin edhe në botën tjetër.

Realiteti na ka dëshmuar se në disa raste (jo në të gjitha rastet) dhënia vullnetare (por edhe e zekatit) ndaj të varfërve ka ndikuar që ata të varfër të pasurohen dhe të rregullojnë gjendjen e tyre materiale. Por pas një kohe, pasi që kanë arritur pasuri ose pozitë, ndoshta nuk janë bërë pabesimtarë, por janë bërë të pamoralshëm dhe degjenerues të shoqërisë dhe jo kontribues; me fjalë tjera janë bërë dëmtues të shoqërisë.

Këtu kemi të bëjmë me fjalën “BEJ’Ë” në kuptim të këmbimit të mallit me këmbim të vlerave.

Programet partiake thërrasin për të mirën e qytetarit, mirëpo fjala “në të mirë të qytetarit” është e papërcaktuar dhe duhet të kërkohet se a është në të mirë të qytetarit për të dy jetët (në këtë botë dhe në botën tjetër). Me fjalë tjera, duhet kërkuar për të rregulluar infrastrukturë ligjore për të fituar edhe këtë botë edhe botën tjetër.

Këtu kemi të bëjmë me fjalën “BEJ’Ë” në kuptim të këmbimit të vlerave.

Nuk mjafton programi për “lirinë e besimit” nëse lirisë së besimit nuk i rregullohet infrastruktura ligjore për realizimin praktik sa më të mirë të besimit.

Sikurse qytetarët të cilët kërkojnë realizimin e projekteve infrastrukturore për rrugë, ujësjellës etj., ashtu duhet siguruar edhe infrastruktura e “ujësjellësit” të besimit dhe infrastruktura e rrugës së praktikimit sa më të mirë të besimit.

## **SI E MENDOJNË “FJALËN E LIRË” ANALISTËT E PALOGJIKSHËM**

Fjalë e lirë është:

- Nëse thua se duhet të gjykohet me drejtësi TOKËSORE, edhe pse në esencë drejtësia tokësore është drejtësi relative; me fjalë tjera, nuk është drejtësi absolute.

Nuk është fjalë e lirë:

- Nëse them se duhet të gjykohet me drejtësi QIELLORE, kur në esencë drejtësia qiellore është drejtësi absolute; me fjalë tjera, nuk është drejtësi relative.

Lirinë e shprehjes, të mendimit dhe të besimit, e cila buron nga QIELLI, dëshiron ta ndalosh me lirinë e shprehjes e cila pretendohet nga TOKA!

## **O SOT, O KURRË!**

O sot, o kurrë, nuk ka ndodhur që të ketë nevojë të shtjellohen:

- Tema për familjen,
- Tema për rrethin e ngushtë të shoqërisë,
- Tema të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar,
- Tema për çështje kulturore islame dhe joislame,
- Tema për çështje ekonomike islame dhe joislame,
- Tema për çështje politike islame dhe joislame (studime krahasuese).

Mirëpo sot, si kurrë më parë, edhe pse ekzistojnë mundësitë e paraqitjes së temave në publik nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit, më shumë shtjellohen (prezantohen) tema sipërfaqësore se sa tema të nivelit më të thellë!

## **ORGANIZIMI BOTËROR**

Në të kaluarën kanë ekzistuar:

- Perandoritë fetare joislame (krishtere, etj.), dhe
- Perandoritë fetare islame.

Pastaj:

Ka filluar një organizim i ri botëror të pavarësimit të shteteve në:

- Shtete laiciste ku përbërja e popullatës ka qenë krishtere dhe të konfeksioneve tjera fetare,
- Shtete laiciste ku përbërja e popullatës ka qenë islame.

Shpërbërja e Perandorisë Osmane i ka përkrahur popujt në formimin e shteteve që në kuadrin e tyre ka qenë përbërja islame. Nga ky këndvështrim është përkrahur edhe formimi i shtetit shqiptar (laik me përbërje islame), mirëpo nga ky këndvështrim, vendet e Ballkanit dhe vendet tjera nuk e kanë përkrahur formimin e shtetit shqiptar (laik me përbërje islame).

Ismail Qemali e ka ngritur flamurin dhe e ka themeluar shtetin e parë laik islam shqiptar, i cili shtet ka vazhduar të

mos pranohej, derisa me shumë e shumë kompromise gjatë viteve është pranuar.

Flamurin nuk e ka ngritur Ismail Qemali, por e ka ngritur: Haxhi Ismail Qemali.

## **CIVILIZIMI**

Sot, kemi një nënë e cila me vështirësi, me mund, me sakrificë dhe lodhje, në kushte të vështira të okupimit ka rritur fëmijët, ku përveç që nuk ka fjetur për përkujdesje të fëmijëve, nuk e ka ngopur barkun me qëllimin e vetëm që kafshatën e fundit ta rezervojë për fëmijën. Ndërsa sot fëmijët e asaj nëne (atyre nënave) ia ka marrë nëna Demokraci, ku fëmijët e kanë idol artistin i cili shkurorëzohet çdo vit, ose artistin i cili nuk martohet kurrë, ose edhe të martuarit me gjini të njëjtë. E, në fund, ajo nënë përfundon jo në shtëpi të pleqve, por në “burgje” të pleqve.

## **TERMI POLITIK**

Siç po shihet:

- Nëse thua se jam musliman dhe i përmbahem fesë, është term politik, ndërsa
- Nëse thua se jam musliman dhe nuk i përmbahem fesë, nuk është term politik.

## **SEKTET E FILLUARA NGA TË TJERËT PËR TË DEMOLUAR UNITETIN ISLAM**

Në shekullin 19, janë projektuar disa lëvizje fetare të cilat në formën e saj të jashtme do të dukeshin islame, por në esencë detyra e atyre lëvizjeve do të ishte që nëpërmjet tyre, të merret pushteti mbi muslimanët.

Kështu që, prej sekteve të filluara nga të tjerët për të demoluat unitetin islam janë:

- Babizmi,

- Behaizmi, dhe

- Vehabizmi.

- Babizmi dhe Behaizmi ishte i përshtatshëm te Shiitët dhe në Lindjen e Largët,

- Vehabizmi ishte i përshtatshëm në qendër të Islamit, në Arabinë Saudite.

Babizmi dhe Behaizmi merreshin me çështje shpirtërore, ndërsa Vehabizmi merrej me çështje fetare.

### 1. Babizmi

Babizmi (Babud Dijnë – Dera e Fesë), themelues Mirza Ali Muhammed, është me prejardhje shiite, i lindur në vitin 1844.

Babizmi ngërthen në vete shumë ide interne ekstreme shiite dhe sufiste, por edhe ide ekstreme krishtere, jehude dhe të feve tjera.

### 2. Behaizmi

Behaizmi është degë e lëvizjes babiste me ndikim nga imamizmi shi'it.

Sipas Behaizmit, pasues të Babit janë edhe Musa, Krishna, Buda, Isa dhe Muhamedi. I fundit dhe më i rëndësishmi është vetë ai; Behaullahu e konsideron veten përmbushje të premtimit nga të gjitha religjionet.

Behaullahu ka vdekur në vitin 1892. Pas vdekjes së tij, e zëvendësoi djali i tij i vjetër Abbas Efendi, i cili më 1908 filloi të zhvillojë aktivitet të ngjeshur, më shumë në Evropë dhe Amerikë e më pak në vendet islame.

### 3. Vehabizmi

Dihet se ndarja e parë në mesin e muslimanëve ka ndodhur për shkak të hilafetit, pastaj ka kaluar në rrafshin fetar.

Vehabijt janë ata të cilët e kanë ndarë qeverisjen shtetërore nga ajo fetare, sepse Saudët dhe Vehabijt kanë

bërë marrëveshje që Vehabijt të merren vetëm me çështjet fetare dhe nuk do të përzihen në çështje shtetërore, dhe Saudët të merren me çështjet shtetërore dhe të mos përzihen në çështjet fetare.

Kjo i ndihmoi Saudëve që të themelojnë shtetin saudit, ndërsa Vehabijt, me pretekstin se Shiitët e konsiderojnë Imamatin (Hilafetin) pjesë të besimit, këta e refuzojnë institucionin e Hilafetit, duke pohuar se Hilafet Universal nuk duhet të ketë.

## **DIPLOMATJA BELKISË**

Mbretëresha Belkisë është model i diplomacisë ndërkombëtare.

Belkisja u ka thënë këshilltarëve, ministrave dhe deputetëve të popullit të saj:

“O ju shtresa e lartë, më ka ardhur një letër me vlerë të rëndësishme. Është dërguar nga peygamberi i Allahut, Sulejmani, i cili është mbret fisnik.”

Kjo letër është nga peygamberi Sulejman dhe fillon me: Bismil-Lahirr-Rrahmanirr-Rrahim – “Në emër të Zotit, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit.”

- Në fjalën “Bismil-Lah” është fakti për të treguar se Zoti ekziston.
- Në fjalën “Bismil-Lah” është dëshmia se është vetëm një Zot.
- Në fjalën “Bismil-Lah” shprehet fuqia dhe mëshira e Zotit.
- Në fjalën “Bismil-Lah” ndalohet arroganca, e cila është pengesë për t’u realizuar e drejta.
- Në fjalën “Bismil-Lah” shprehet ndalesa e pabesimit.
- Në fjalën “Bismil-Lah” urdhëroheni për përqafimin e Islamit.

## **HOXHA MODERN**

Nuk është hoxhë i ditur, por menaxher (drejtues) i mirë.

Pastaj:

Nuk është menaxher (drejtues) i mirë, por politikan (hoxhë) i mirë.

Në fund:

Nuk doli të jetë politikan (hoxhë) i mirë, por izolues i mirë i Islamit.

## **PSE MENDON SE DUHET TË VOTOHESH PËR KRYETAR KOMUNAL?**

Nga shkaku se:

- Kam qenë lëng i hedhur;
- Pastaj jam bërë gjak i ngjizur;
- Pastaj gjaku im është formësuar në mish;
- Pastaj mishi im është formësuar si lëndë e ngurtë eshtre;
- Pastaj eshtrat e mia janë mbuluar me mish;
- Pastaj kam lindur dhe nuk kam ditur asgjë;
- Nuk kam ditur as të flas;
- Nuk kam mundur të eci vet;
- Pastaj jam rritur;
- Tashti e ndiej veten të ditur, por...;
- Pastaj do të dobësohem;
- Do të më kalben eshtrat;
- Do të hy nën dheun e komunës sime, dhe
- Do të jap llogari për veten dhe për përgjegjësinë që do ta marrë.

## **DISKRIMINIMI**

Ka lloje të ndryshme të diskriminimeve; një prej tyre është diskriminimi i emërtimeve.

## **NDARJA E FESË NGA SHTETI**

Ndarja e fesë nga shteti ka filluar në krishterim, ndërsa nevoja e shtetit për fe fillon me fenë islame.

## **KURIOZITET**

Janë tri lloje të “shejtanëve”:

- Lloji i cili frikohet nga ajetul-KURSIJA (ajeti madhështor në Kur’an),
- Lloji i cili frikohet se po e humb KURSIJËN (pozitën, karrigen),
- Lloji i cili i aplaudon të ulurit në KURSIJ (në pozitë, në karrige).

## **NGUSHËLLIMI**

Dëgjojmë në tubime, lexojmë në shkrime:

- “Qenka ndarë nga jeta”,
- “U prehtë në paqe”,
- “Prehu në paqe”,
- “Pusho i qetë”,
- “I paska mbyllur sytë përjetësisht”.

Dhe, duke mos e përmendur së paku njëherë Zotin, duke mos u lutur që së paku Zoti të mëshirojë një besimtar musliman ose haxhi, nga një musliman tjetër, edhe atë në momentet më të rëndësishme të individit, është për keqardhje.

### **E REJA NDËRTOHET DUKE MOS E SHKATËRRUAR TË VJETRËN**

- Xhamia te Ura e Ibrit në Mitrovicë u prish dhe u dogj nga forcat serbe në luftën e fundit, ndërsa
- Xhaminë mbi Kalanë e Prizrenit e kanë prishur laicistët shqiptarë, të cilët hezitojnë të japin leje për rindërtimin e saj edhe pse ka kaluar afro një shekull.
- Laicistët komunist shqiptarë në kohën e Rankoviqit burgosnin, maltretonin dhe ekzekutonin hoxhallarë, ndërsa

- Laicistët komunist jugosllav përgatitnin kuadro fetarë të tyre dhe klerikët e tyre për veten e tyre.
  - Laicistët komunist shqiptarë ndjenin turp që ishin me hoxhallarët.
  - Laicistët serbë krenoheshin me klerët e tyre fetarë.
  - Laicistët demokrat kosovarë e proklamojnë veten e tyre në festa Bajrami për të përfituar ndonjë votë për zgjedhjet në vijim.
  - Laicistët demokrat serb dhe klerikët e tyre qëndrojnë së bashku për realizimin e interesave të tyre politike.
  - Historianët komunist të Kosovës, të cilët ishin në shërbim të komunizmit, nuk e ngritnin zërin kur ishte motoja “ta shkatërrojmë të vjetrën, ta ndërtojmë të renë”; ku në emër të kësaj motoje shkatërroheshin xhami (vendvarrresa shqiptare etj.) nëpër qendra të qyteteve të Kosovës për t’u bërë qytete së reja socialiste, ndërsa
  - Historianët demokrat të Kosovës, të cilët deri dje ishin në shërbim të komunizmit, sot e ngritin zërin duke thënë: “Ta ndërtojmë të rejën duke mos e shkatërruar të vjetrën.”
- E reja ndërtohet duke mos e shkatërruar të vjetrën.

## **LIDHJA E PRIZRENIT APO KUVENDI KOMBËTAR I PRIZRENIT**

Lidhja e Prizrenit nuk ka qenë lidhje ashtu siç quhet, por ka qenë Kuvend Kombëtar. Këtë mund ta argumentojmë si në vijim:

Në rend të parë: Nuk quhet lidhje dhe nuk ka qenë lidhje, por Kuvend.

Në rend të dytë: Ka qenë Kuvend Kombëtar.

Në rend të tretë: Ka qenë Kuvend i udhëhequr nga dijetarët eminentë islamë për të udhëhequr atdheun.

Në rend të katërt: Ky Kuvend ka qenë në kuvendin (objektin) islam.

Në rend të pestë: Ka qenë Kuvend për mbrojtjen dhe sigurinë e atdheut nga shtetet përreth të cilët dëshironin t'i okuponin tokat shqiptare.

## **ZOTËRIU DHE ROBI I POLITIKËS**

Politikanët tanë janë robër të politikës me të huajt, ndërsa zotërinj të politikës me qytetarin.

Krerët e BIK-ut janë robër të politikës me politikanët tanë, ndërsa zotërinj të politikës me qytetarin.

Qytetarët janë robër të politikës me qytetarët, ndërsa zotërinj të politikës në familje.

Do të duhej të ishte e kundërta; shumë lehtë është të bëhesh rob i politikës ditore, por vështirë është të bëhesh zotëri i politikës (ta mbizotërosh politikën), sepse politika nuk është të ushqesh barkun, por të ushqesh trurin. Truri ushqehet me dituri, barku ushqehet me ushqime të cilat do t'i hanë krimbat.

## **MEDIET**

Islami është për:

Shoqërinë;

Familjen dhe për;

Individin.

Mediet nuk i japin hapësirë Islamit të merret me çështje politike. Për këtë arsye, duke u dhënë hapësirë politikanëve dhe duke dalë shumë nëpër media, është bërë:

Gënjeshtër art;

Mosmbajtja e premtimit aftësi; dhe

Mashtrimi vlerë.

Mediet nuk i japin hapësirë Islamit të merret me çështjet e familjes. Për këtë arsye, duke u dhënë hapësirë atyre të cilët nuk kanë sukses për të krijuar familje (se nuk mund ta mbajnë familjen) dhe duke u dhënë hapësirë politikanëve, familja shndërrohet në një ambient ku nuk sheh shpresë të politika.

Mediet nuk i japin hapësirë Islamit të merret me çështje të individit në shoqëri; për këtë arsye individit e konsideron veten të paaftë për ndryshimin e gjendjes.

## **TERMINOLOGJITË**

Feja Islame i ka specifikat e veta, sikurse edhe lëmitë e tjera i kanë specifikat e tyre.

Termi “namaz” nuk mund të shndërrohet në termin “lutje”.

Termi “haxh” nuk mund të shndërrohet në termin “pelegrinazh”.

Termi “imam” nuk mund të shndërrohet në termin “kler” (klerik).

Termi “kryetar” i një institucioni islam nuk mund të shndërrohet në termin “myfti”.

## **SHKOLLA E PARË SHQIPE**

Shkolla e Korçës nuk është shkolla e parë shqipe, por është shkolla e parë laike shqipe, sepse kanë ekzistuar edhe para saj shkollat fetare shqipe. Në shkollën e Korçës nuk është mësuar me këto shkronja (A, B, C), sepse këto shkronja të vendosura në oborr të shkollës së parë laike shqipe janë bërë pjesë e shkrimit të gjuhës shqipe 21 vite më vonë, pra në Alfabetin e Kongresit të Manastirit (14 nëntor - 22 nëntor 1908), ndërsa shkolla e Korçës u hap më 7 mars të vitit 1887 (dallimi mes tyre është 21 vite).

## **LETËRSIA SHQIPE ME ALFABET ARAB**

Në fund të shekullit XVII, vërehet fillimi i përparimit të letërsisë shqipe të shkruar me shkronja arabe, deri pas pavarësisë së Shqipërisë, në vitin 1912.

Poema e gjatë “Kafe” daton në vitin 1724, me autor Muçi Zade.

Poemat (divanet) e tyre: Nazim Frakulla dhe Sulejman Naibi.

Në fund të shekullit XVIII njihet Hasan Zyko Kamberi, i cili, përveç divaneve poetike të tij, ka lënë edhe poemën lidhur me lindjen e Muhamedit (a.s.) në gjuhën shqipe.

Në qytetin e Shkodrës ishin të njohur Husejn Diraçi dhe Salih Bata.

Nuk duhet harruar as Muhamed Çami, ku veprat e tij letrare më të njohura konsiderohen eposi i gjatë “Erveheja” që ka 856 vargje dhe eposi “Jusufi dhe Zylihaja” me rreth 2400 vargje (bejte).

Me fillimin e shekullit XIX, në gjuhën shqipe nisi të përhapej një formë e re letrare, e zhvilluar midis ndjekësve, mes të cilëve Dalip Frashëri me eposin e tij “Kopshti”, që konsiderohet eposi më i gjatë në letërsinë shqipe dhe përmban 65 mijë vargje. Ai ndiqet nga i vëllai, Shahin Frashëri, i cili ka shkruar eposin e titulluar “Muhtarname”, në vitin 1868, me 13 mijë vargje. Këto poema dhe të tjera kanë frymëzuar poetin Naim Frashëri që të shkruajë poemën e tij “Qerbelaja” në fillim të këtij shekulli.

Tahir efendi Gjakova, i cili u bë i njohur me poezinë e tij “Vehbija”, të botuar në vitin 1835. Tahir Popova, autorin e poezisë për lindjen e Muhamedit (a.s.), e botuar në vitin

1873, që vazhdon të lexohet edhe në ditët e sotme midis muslimanëve shqiptarë.

## **URIMI ME LULE TË PLASTIKËS**

Të jesh mësues për punimin e tokës, “nuk je mësues i mirë” se i mëson të tjerët për të qenë BUJK, dhe profesioni i BUJKUT nuk është i mirë.

Të jesh mësues për rritjen e kafshëve shtëpiake “nuk je mësues i mirë” se i mëson të tjerët për të qenë BLEGTOR dhe nxënësin e quajnë ÇOBAN, dhe profesioni i ÇOBANIT nuk është i mirë.

Të jesh mësues për të fituar botën tjetër “nuk je mësues i mirë” sepse nxënësit quhen fetarë dhe mbeten të prapambetur dhe shoqëria nuk zhvillohet.

Të jesh mësues për filozofinë ateiste dhe për mosbesimin në Zot, je mësues i mirë dhe BASHKËKOHOR dhe e zhvillon shoqërinë.

Në fund: Urohet mësuesi me lule të plastikës, të cilat nuk kanë as shije, as ngjyrë dhe as erë!

## **FETVAJA MË E NJOHUR**

Fetvaja më e njohur të cilën e dëgjojmë kohëve të fundit është: “Asnjëherë nuk na ka ndodhur një rast i tillë deri më tash!?”.

Për ndodhinë e cila ka ndodhur para nesh e kanë dhënë Fetvanë ata të cilët kanë jetuar para nesh.

Arsyetimi para njeriut nuk do të thotë se është arsyeshmëri para Zotit!

## **LAICISTI**

Dola nga shtëpia dhe hyra në një ambient të hapur dhe të bukur të një kafeterie dhe përshëndeta: “Esselamu alejkum” (Paqja dhe shpëtimi qofshin mbi ju).

Një laicist tha se kjo përshëndetje është përshëndetje politike sepse dëshiron të na sjellësh ndikim arab te ne.

U ula në tavolinë, një shok më përshëndeti duke më thënë “Merhaba” (Mirë se erdhe).

Laicisti prapë tha se kjo përshëndetje është përshëndetje politike sepse dëshirohet të silllet ndikimi i Turqisë në vendin tonë.

## **KAPITULLI NJËMBËDHJETË:**

### **TË NDRYSHME**

## **BËN MIRË**

Ishte mëngjesi i ditës:

Musa a.s. :

- Nuk kishte shtëpi;
- Nuk ishte i martuar dhe
- Ishte i pa punë .

E bëri një të mirë dhe është lutë: **“Zoti im, unë kam nevojë për gjithçka por më mjafton çka do që të më japësh.”**

Para se të perëndonte dielli i asaj dite Allahu i Madhërishëm i përgjigjet pozitivisht:

- Ia mundëson të siguron shtëpi (banesë)
- Ia mundëson të martohet, dhe,
- Ia mundëson të siguron punë.

Andaj: bëje një mirë dhe pas asaj të mire bëj lutje, me shpresën se Zoti do të të përgjigjet pozitivisht dhe t'i realizon dëshirat.

## **DOBIA E SË MIRËS**

Në natyrë çdo gjë, çdo element jeton dhe vepron për tjetrin (tjerët):

- Lumi nuk e pi ujin e vet.
- Deti nuk i hanë peshqit e vet.
- Lisat nuk i hanë gjethet e tyre
- Pemët nuk i hanë frytet e tyre
- Dielli nuk rrezon për veten e vet
- Lulja nuk lëshon aromë për veten e saj

Elementet në natyrë janë për të qenë në shërbim të të tjerëve.

Kjo është Urtësi e Zotit dhe mesazh prej Tij.

Atëherë edhe ne të jemi në shërbim të njëri-tjetrit.

Çdo gjë rreth nesh zhduket, ndërsa e mira mbetet dhe nuk zhduket. Ajo mbetet e rrënjosur në veten tonë.

Andaj:

Kur të vjen ndokush për të kërkuar ndihmë apo mbështetje dije se më shumë ke dobi ti prej tij se sa ai prej teje. Allahu e ka drejtuar për te ti dhe e ka çelë derën e mirësisë për ty.

## **ANALIZONI FJALËT E ZOTIT**

Analizoni fjalët e Zotit të Madhërishëm të specifikuar në Kur'an:

- Kush i kupton argumentet e Zotit, ai i kupton për veten e vet.
- Kush bënë një të mirë, atë të mirë e ka bë për veten e vet.
- Kush falënderon, ai falënderon për veten e vet.
- Kush e pastron shpirtin e vet, e pastron për veten e vet.
- Kush përpiqet (për rrugën e drejtë), përpiqet për veten e vet.
- Kush udhëzohet, udhëzohet për veten e vet.
- Kush e thyen betimin e Zotit, e ka thyer për veten e vet.
- Kush vepron një të keqe, ai vepron keq për veten e vet.

## **I DOBËTI I FORTI DHE UJI**

- Ujit të qetë, kahjen mund të ia devijoj edhe i forti edhe i dobëti
- Ujit të rrëmbyeshëm nuk mund të ia devijon as i dobëti dhe as i forti.
  
- Në ujë mbytet i forti i cili nuk di të notoj, ndërsa
- Në ujë nuk mbytet i dobëti cili di të notoj.
  
- Në ujë fundoset gozhda 5 gramëshe ndërsa
- Në ujë nuk fundoset anija qindra tonësh.
  
- Në ujë është fundosur Firauni me ushtrinë e fortë të tij.
- Në ujë nuk është fundosur Musau a.s. si foshnje në sëndukun e tij.

## **LLOJET E MJEKËVE**

Kemi dy lloje të mjekëve :

- Mjek njeri dhe
- Mjek jo njeri.

Mjekët jo njeri janë më të vlefshëm se mjekët njeri.

Andaj:

Vizito mjekun “DIELL” para se të shkosh te mjeku njeri.

Vizito mjekun “AJRI I PASTËRT” para se të shkosh te mjeku njeri.

Vizito mjekun “USHQIMI I SHËNDETËSHËM” para se të shkosh te mjeku njeri.

Vizito mjekun “LEXIMI I KUR’ANIT”. Kjo ngase Leximi i Kuranit është edhe ushqim edhe ilaç i mendjes dhe i shpirtit.

Vizito mjekun “KADAJA E ZOTIT”. Kjo ngase ajo çka ndodhë në të kaluarën nuk ke mund ta parandalosh qoftë të ketë qenë e mirë apo e keqe.

Për diagnozën e ngushtimit të frymëmarrjes përdore fjalën “LA ILAHE IL-LALLAH”.

Për diagnozën e mëkateve përdore ilaçin “ESTAGFIRULLAH”.

Terapitë filloji me “BISMILAH” ndërsa përfundoi me “ELHAMDULILAH”.

## **MIZA ME KAUN**

Tregohet se një mizë ka zbarkuar mbi bririn e kaut lëvrues, i cili ishte duke lëvruar tokën. Kur është kthyer në strofullin e saj, miza tjetër e pyet: “Ku ishe?” Miza i përgjigjet: “Ishim duke lëvruar tokën.” Kështu është çështja me disa njerëz. Mundin dhe suksesin e të tjerëve ia bashkëngjisin vetes së tyre.

## **SELEKTIVITETI I OBLIGIMEVE**

Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Fale namazin dhe jepe zekatin.”

Ka prej njerëzve të cilët e falin namazin dhe japin zekatin; por,

Ka prej njerëzve të cilët e falin namazin dhe nuk e japin zekatin.

Ka prej njerëzve të cilët nuk e falin namazin dhe nuk e japin zekatin, por agjërojnë.

Ka prej njerëzve të cilët nuk e falin namazin, nuk e japin zekatin, nuk agjërojnë, por e thonë Shehadetin; vetëm se:

Kur e thonë Shehadetin, e thonë “ESHEDU” dhe nuk e thonë “ESH-HEDU”. Nëse i thuhet se pse nuk e mëson mirë!? Thotë: “Aq kam aftësi”, ndërsa:

është i aftë të mësojë dhjetëra këngë për të shkuar në dasma;

është i aftë të mësojë dhjetëra tregime për të shkuar në vendtubime për t'i treguar;

është i aftë të mësojë dhjetëra rregulla të komunikacionit për të shkuar ku të dëshirojë; ndërsa

nuk është në gjendje të mësojë një fjalë në rregull (SHEHADETIN), e cila fjalë e dërgon në XHENET.

## **MOS FOL**

Mos fol, se është rast vdekje. Mos fol, se je në dasmë. Mos fol, se është çështje politike, hidhërohet Kryeministri. Në ditën e gjykimit: Mos fol, se nuk e ke parandaluar të keqen, bile edhe i ke ndihmuar asaj.

O ju që besuat! Zbatoni premtimet (obligimet).

## **ANKIMIMI**

Kishte përfunduar lufta. Ishte një tubim. Në atë tubim ishte një person të cilit i ishte vrarë: baba, djali dhe vajza. I ishte djegur shtëpia në tërësi. Ai qëndronte i heshtur dhe mendohej t'i shëronte plagët e tij duke mos i lënduar të tjerët, mendohej t'i shëronte plagët e të tjerëve. Në atë mes ishte edhe një person tjetër i cili tregonte (duke u ankuar): "Pasi përfundoi lufta u ktheva në shtëpi. Pashë se shtëpia ishte e padëmtuar, vetëm se e kisha një kotec; koteci ishte demoluar, pulat silleshin nëpër oborr, ndërsa i pashë nja dy vezë të cilat ishin thyer, ndërsa vezët e tjera kishin mbetur të paprekura." P.S. Tregonte vezët e thyera, kotecin e demoluar dhe pulat e shpërndara nëpër oborr në tubimin ku kishte person të cilit i ishte djegur shtëpia dhe i ishte vrarë baba, djali dhe vajza.

## **INVESTIMI I DREJTË**

Investimi në teknologji (makineri) për jomakinerinë (njeriun) është natyrshëm.

Investimi në njeriun që të shndërrohet në makineri është jonatyrshëm.

## **KOMBËTARË**

Gjyshërit (baballarët) dhe gjyshet (nënat) tona:

E kanë ditur çka është atdheu.

E kanë ditur se si mbahet familja.

E kanë ditur se si shtohet familja.

E kanë ditur si mbrohet familja. Me një fjalë: E kanë shtuar kombin tonë me të gjitha sakrificat dhe u kanë përballuar të gjitha vështirësi.

Sot:

E dimë çka është atdheu.

Nuk jemi duke ditur se si krijohet familja.

Nuk jemi duke ditur se si shtohet familja.

Nuk jemi duke ditur se ku e gjen lumturinë familja.

Me një fjalë: E pakësojmë kombin tonë duke i shkaktuar vështirësi sepse nuk jemi në gjendje të sakrifikojmë kohë për krijimin e familjes, nuk dëshirojmë të prishim qetësinë tonë, e që në realitet nuk është qetësi, por heshtje e cila do të sjellë shqetësim.

## **MIRË DHE KEQ**

Nuk ka më mirë se kur: “Fjala ndryshe shkruhet ndryshe në të shkruar.” Nuk ka më keq se kur: “Fjala ndryshe të mos shkruhet ndryshe në të vepruar.” Edhe më keq është atëherë kur: “Fjala ndryshe të shkruhet në mendje dhe të mos shkruhet as në të shkruar dhe as në të vepruar.”

## **APLAUDIMI**

Një Halid bin Velid është shndërruar në hero islam edhe pse në fillim kishte luftuar muslimanët, por nuk ka ndodhur që Abdullah bin Seluli të quhet hero islam. Tek në spiuni bëhet hero dhe vazhdon me dyfytërsinë e tyre dhe e aplaudojnë!

## **MOBILIZIMI**

Mobilizim për këtë...

Mobilizim për atë...

Mobilizim edhe për këtë...

Mobilizim edhe për atë...

A ka mobilizim për fenë islame, e cila na ndriçon rrugën në këtë botë për mobilizimet e tjera dhe për në botën tjetër?

## **MONSTRUM**

Ka një lloj mishi i cili po të shitej në ndonjë shitore, të gjithë njerëzit do ta urrenin atë shitës dhe do të largoheshin nga aty, dhe shitësin do ta quanin MONSTRUM; mirëpo përkundër kësaj, ka prej njerëzve që, edhe pse do të ikin me të katërtat nga ajo shitore, ata prapëseprapë e konsumojnë atë lloj mishi. Këtë lloj mishi Kur'ani fisnik e përshkruan si në vijim: **“O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgjoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë MISHIN E VËLLAIT TË VET TË VDEKUR? Atë pra urrejeni!”** (Huxhurat, 12)

## **E LEHTA, E VËSHIRË**

Nëse u thuhet fëmijëve (pasardhësve të tyre):

Mëso shkronjat e Kur'anit: “Shkronjat arabe janë të vështira”, – përgjigjet.

Mëso mënyrën e faljes së namazit: “Është e vështirë të mësoj faljen e namazit”, – përgjigjet.

Shko blej bukë për mëngjes: “Nuk mundem sepse ja, sa u zgjova nga gjumi”, – përgjigjet.

Shko puno: “Është punë e rëndë, është ftohtë (ose nxehtë)”, – përgjigjet.

Kryeje këtë punë edhe pse është e vështirë: “Është absurde, kjo punë kurrë nuk mund të bëhet”, – përgjigjet.

Nëse i thuhet: Pusho: “Nuk mundem të pushoj, se jam lodhur duke pushuar”, – përgjigjet.

Me një fjalë: Të lehtë e bëjnë të vështirë, ndërsa të vështirën e bëjnë të pamundur!!!!????

## **LËRI ANASH FJALËT E NJERËZVE DHE VAZHDO**

### **PËRPARA**

Një tufë bretkosash ishin duke udhëtuar së bashku. Rastësisht, dy prej tyre bien në një gropë të thellë. Bretkosat e tjera, duke parë se dy bretkosat e kishin të pamundur të dilnin nga aty, u thoshin atyre dy bretkosave se, sa do që të mundoheshin, e kishin të pamundur të dilnin nga aty, andaj duhej të dorëzoheshin deri në vdekje.

Faktikisht, njëra prej tyre ngordhi.

Derisa tjetra vazhdonte të kërcente, të tjerat i thoshin se e kishte të pamundur dhe se nuk duhej ta mundonte veten duke tentuar të kërcente. Mirëpo, ajo duke kërcyer vazhdimisht ia arrin qëllimit dhe del nga gropa.

Kur e kanë pyetur se si ia kishte arritur qëllimit, janë befasuar me faktin se ajo kishte qenë e shurdhër dhe memece. Në fakt, ajo kishte menduar se të tjerat e kishin motivuar, edhe pse kishte qenë e kundërta. Të tjerat nuk e kishin motivuar, por kishin tentuar t'ia prishnin ardhmërinë e saj.

## **NDËRRIMI I QËNDRIMEVE**

Tregohet se një njeri ka varrosur qenin e ngordhur në vendvarrezat e muslimanëve. Atë njeri e denoncojnë te kadiu për t'u gjykuar! Kadiu e fton në seancë gjyqësore dhe e pyet për atë veprim. Ai i thotë: "Qeni ma ka lënë porosi (testament), kështu që ia kam zbatuar testamentin e tij." Kadiu i thotë: "Mjerë për ty! Ti po tallesh me ne?" Ai i thotë: "Po ashtu, qeni më ka lënë testament 10000 dinarë për ty." Kadiu thotë: "Zoti e mëshiroftë qenin!" Njerëzit habiten se si e ndërroi qëndrimin aq shpejt. Kadiu thotë: "Mos u habitni, e mendova çështjen e këtij qeni të mirë dhe arrita në përfundim se është nga loza e qenit të Eshabul-Kehfit (Banorëve të Shpellës)."

Kjo është gjendja aktuale: Disa njerëz i ndërrojnë qëndrimet dhe parimet, e flasin të pavërtetën, e pastaj atë të pavërtetë e mbrojnë në bazë të apetiteve të tyre dhe në bazë të interesit të tyre.

## **GJITHÇKA 1 EURO!**

Ka shumë prej atyre të cilët hallallin dhe haramin e konsiderojnë sikurse artikujt në shitore: "GJITHÇKA 1 EURO!".

## **ÇKA E NDRIÇON ZEMRËN**

Zemrën e ndriçojnë:

Largimi nga mëkatet; dhe

Mosangazhimi në çështjet të cilat nuk të takojnë.

## **KUSH DUHET TË FLASË DHE PËR ÇKA DUHET TË FLASË**

Në shumë vendkuvendime hoxha flet për sport (kulturë, etj.), ndërsa nga vendkuvendimi, ai i cili nuk është hoxhë flet për ligjet e shariatit dhe tregon se shiari është çështje e vjetruar; ndërsa vendkuvenduesit edhe për të parin edhe për të dytin dëgjojnë me vëmendje dhe heshtin.

## **TREGU DHE MEDIAT**

Në treg paguajmë, por marrim çka dëshirojmë, ndërsa mediet (programet televizive) i paguajmë dhe na servojnë çka dëshirojnë.

## **FAJTORI**

Hyri hoxha në dhomë. Të gjithë e prisnin fjalimin e tij. Ai filloi të fliste për zekatin. Gjatë fjalimit hyri një njeri në dhomë. Ai njeri i kishte ndihmuar në disa raste hoxhës. Ai ishte një pasanik i cili kurrë nuk e kishte dhënë zekatin.

Hoxha e falënderoi njeriun dhe i shprehu lëvdata e vazhdoi temën, por nuk e përmendi se ai i cili nuk e jep zekatin e ka kundërshtuar urdhrin e Allahut, vetëm se tha se bujaria e atij njeriu ia tejkalon të gjithëve. Në dhomë kishte të devotshëm të cilët ishin bujarë, por fat(keq)mirësisht ishin të varfër.

E në dhomë ishte një njeri mesatar. Ai kishte dëshmuar se një njeri nuk e kishte dhënë zekatin. Pa e përcaktuar njeriun, hoxha tha: “Ai i cili flet për tjetrin, ai do të ndëshkohet.”

Nuk është faji te ta, por faji është te të tjerët të cilët i duartrokasin ata!!!?

## **TRUPI FIZIK DHE SHPIRTI I NJERIUT**

Nëse trupi është i ngopur ndërsa shpirti është i uritur, atëherë edhe shpirti kërkon ushqim ashtu sikurse trupi i cili kërkon ushqim kur është i uritur. Ushqimi i shpirtit është: “Përmendja ndaj Zotit”. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Duke e përkujtuar Zotin qetësohen shpirtrat (zemrat)”**.

Tërmeti është ligj i Zotit në tokë. Ashtu siç Zoti e urdhëron tokën të dridhet, ashtu mund ta urdhërojë të qetësohet. Tërmeti shkakton dëme materiale, por përpos dëmit material shkakton dhembje në gjithë shoqërinë. Shkakton lot e pikëllim në gjithë shoqërinë. Lotët dhe dhembjet vazhdojnë, por shpirti dhe zemrat dëshirojnë të qetësohen. Paralelisht me ndihmat materiale milionëshe, shumë pak u ndihmohet në qetësimet e zemrave. Shohim portalet, mediet, programet televizive, nuk e përmendin Zotin ashtu siç e meriton. Tubuesit e ndihmave nëpër TV nuk e përmendin Zotin siç e meriton.

Dihet se Karuni fundosej në tokë (e përpinte toka) dhe, edhe pse ishte duke e parë veten duke u fundosur, nuk e përkujtonte Zotin dhe u fundos me pasurinë e tij. Në anën tjetër, Firauni u ngrit mbi det dhe atëherë ai u kujtua dhe para fundosjes e përkujtoi Zotin, por ai përkujtim ndaj Zotit nuk iu pranua dhe e përmyti deti.

Të mos harrojmë, të mos hezitojmë, por ta dimë dhe ta praktikojmë përkujtimin ndaj Zotit edhe në kohë të mira edhe në kohë të vështira, sepse përmendja ndaj Zotit i qetëson zemrat tona dhe e fitojmë mëshirën dhe ndihmën e Zotit dhe e fitojmë edhe këtë botë edhe botën tjetër.

## **MUSAFIRI**

Shtëpia e cila mirëpret musafirë është shtëpi të cilën e do Zoti! Shtëpia e mirë është shtëpia e cila është e hapur për të voglin e për të madhin, shtëpi e cila përfiton mëshirën dhe zbritjen e bereqetit nga qielli.

Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Nëse Zoti ia do të mirën një njeriu, i dërgon dhuratë.”

“Cila është ajo dhuratë?” – e kanë pyetur.

“Musafiri i cili sjell riskun dhe i merr me vete (i largon) mëkatet e asaj shtëpie”, – është përgjigjur.

Pejgamberi a.s. ka thënë: ***“Shtëpia e cila nuk mirëpret musafirë, nuk vizitohet nga melekët”***. Pejgamberi a.s. ka thënë: ***“Musafiri është dëshmi për xhenet”***. Pejgamberi a.s. ka thënë: ***“Kush beson në Zotin dhe në ditën e gjykimit, le ta nderojë musafirin”***.

## **VEPRIMI SHKON PARALELISHT ME TË PIKSYUARËN**

Në jetë pikësynojmë për atë çka është:

- MË E RËNDËSISHMJA
- SHUMË E RËNDËSISHME
- E RËNDËSISHME
- MË PAK E RËNDËSISHME

Për më të rëndësishmen – duhet shpejtuar me vrap.

Për shumë të rëndësishmen – duhet shpejtuar.

Për të rëndësishmen – duhet ecur me hapa normalë.

Për më pak të rëndësishmen – duhet ecur me hapa të ngadaltë (me kujdes).

Për më të rëndësishmen, Allahu i Madhërishëm thotë:

**FE FIRRUU ILELL-LLAH...**

**– Shpejtoni me vrap për te Allahu.**

Për shumë të rëndësishmen, Allahu i Madhërishëm thotë:

**VE SARIUU ILA MAGFIRETIN MIN RABBIKUM VE  
XHENNETIN**

**- Shpejtoni për të realizuar pranim-faljen nga Zoti juaj  
dhe për xhenetin...**

Për të rëndësishmen, Allahu i Madhërishëm thotë:

**FESAU ILAA DHIKRIL-LAAH...**

**- Ecni me hapa normalë në lutje (adhurim).**

Për më pak të rëndësishmen, Allahu i Madhërishëm thotë:

**FEMSHUU FII MENAKIBIHA...**

**- Ecni me hapa të ngadaltë (me kujdes për furnizim) mbi sipërfaqen e saj (të tokës).**

Me një fjalë:

Shpejtimi me vrap bëhet në rrugën për te Allahu.

Shpejtimi bëhet në rrugën për në xhenet.

Ecja me hapa normalë bëhet për adhurim.

Ecja me hapa të kujdesshëm (të ngadaltë) bëhet për furnizim të jetës.

Ne bëjmë të kundërtën:

Shpejtojmë me vrap për furnizimin e jetës, përderisa furnizimi është pjesë e pandashme e jetës, për të cilën vetëm duhet ecur me hapa të ngadaltë dhe me kujdes.

Bëjmë hapa të ngadaltë duke shpresuar se xheneti vrapon pas nesh.

Qëndrojmë në këmbë në një vend dhe vetëm i kryejmë adhurimet, të cilat adhurime nuk sjellin aktivizimin e shpirtit, të zemrës dhe të pjesëve të tjera të trupit.

Qëndrojmë në gjumë për çështjen më të rëndësishme të jetës, duke shpresuar se në gjumë e fitojmë kënaqësinë dhe dashurinë e Allahut.

## **TREGTIA ME NJERIUN DHE TREGTIA ME ALLAHUN**

Tregtia me njeriun:

Bli një, një falas.

Bli dy, një falas.

Bli pesë, një falas.

Bli dhjetë, një falas.

Tregtia me Allahun:

Vepron një të mirë, dhjetë falas.

Vepron një të mirë, shtatëdhjetë falas.

Vepron një të mirë, shtatëqind falas.

Vepron një të mirë, pakufi falas.

## **MOS U MERR ME ÇËSHITJE DYTËSORE**

Ata të cilët thonë: “Mos u merrni me çështje dytësore”, vetë ata tërë kohën flasin dhe debatojnë për çështje dytësore.

Ata të cilët thonë: “Mos shkaktoni përçarje”, vetë ata në mënyrë indirekte më së shumti shkaktojnë përçarje dhe ngecje.

Ata të cilët thonë: “Të mos ju mashtrojë dunjaja”, vetë ata janë më të mashtruarit në këtë dunja.

Ata të cilët thonë: “Pa dituri, punë dhe angazhim nuk mund të ecim përpara”, vetë ata me atë dituri (të paktë apo të shumtë) të cilën e kanë, nuk e vendosin në praktikë për të ecur përpara.

Zoti i Madhërishëm u adresohet besimtarëve në mënyrë specifike:

**“O ju besimtarë, po pse po e thoni atë të cilën (vetë) nuk e veproni?” (Saf, 2)**

## **ÇKA PRITET**

Çka pritet nga i riu i cili e ka idhull atë i cili shkurorëzohet çdo sezon?

Çka pritet nga i riu i cili bën tifo për atë i cili nuk shkon në varrim të babait?

Çka pritet nga i riu i cili është fans i atij i cili nuk martohet kurrë?

## **KONKURSI**

Nëse organizohet konkurs (garë) i piktorëve botërorë për të paraqitur portretin e shejtanit në pikturë, në atë konkurs marrin pjesë një milion piktorë. Kush do të fitonte vendin e parë?

Përgjigjja: Vendin e parë do të fitonte piktori i cili e paraqet portretin e shejtanit në formën më të keqe të mundshme, sepse në konkurs nuk kërkohet portreti i melaqes. Etika e vërtetë është që rezultati të jetë në harmoni me gjendjen paraprake të saj.

## **MË E MIRA**

E kanë pyetur një të urtë:

Cila është gjëja më e mirë për njeriun? — (Ai i përgjigjet):  
Mendja me të cilën jeton.

Po nëse atë nuk e ka? — Vëllezërit, të cilët përkujdesen  
për të.

Po nëse ata nuk i ka? — Pasurinë, për shkak të së cilës e  
duan njerëzit.

Po nëse nuk e ka? — Edukatën, prej së cilës ruhet prej çdo  
të keqeje.

Po nëse nuk e ka? — Heshtjen, e cila e shpëton.

Po nëse nuk e ka? — Vdekjen, e cila i shpëton njerëzit prej  
tij.

## **NUMRAT ARAB**

Babai i Abdullahut, Muhamedi i biri i Musaut, me nofkën el-Huarizmi, është arkitekti, projektuesi dhe zbuluesi i numrave të cilët quhen numra arabë, e të cilët numra i përdor e gjithë bota. Ja rruga të cilën ai ka ndjekur në përdorimin e numrave:

Njëkëndëshi: është numri 1

Dykëndëshi: është numri 2

Trekëndëshi: është numri 3

Katërkëndëshi: është numri 4

Pesëkëndëshi: është numri 5

Gjashtëkëndëshi: është numri 6

Shtatëkëndëshi: është numri 7

Tetëkëndëshi: është numri 8

Nëntëkëndëshi: është numri 9

Asnjëkëndëshi: është numri 0

## **PROGRAMI I JETËS STABILE**

Veproni me drejtësi.

Mos bëni padrejtësi.

Mos shkaktoni ngatërresa në tokë.

Mos e ngatërroni të mirën me të keqen.

Mos jep mendim për atë që nuk e di.

Mos ec me kryelartësi.

Njerëzve mos ua kthe shpinën.

Bëhu i butë me besimtarët.

Ule zërin.

Ec me modesti.

Distancohu dhe qëndro larg nga injorantët.

Merre të lehtë dhe urdhëro për të mirë.

Të keqen largoje me të mirë.

Në rrugë të Zotit thirr me urtësi.

Mos jepni lëmoshë me krekosje (proklamime) dhe me ofendime.

Mos e keqpërdorni pasurinë e njëri-tjetrit.

Mos e thirrni njëri-tjetrin me emra të padëshiruar (lakabe).

Mos u tallni (mos e nënçmoni) me njëri-tjetrin.

Mos e përgojoni njëri-tjetrin.  
Mos shpifni për njëri-tjetrin.  
Largohuni nga mendimet e këqija.  
Hyni në paqe në përgjithësi.  
Kur të përshëndeteni, kthejeni përshëndetjen edhe më mirë.  
Nderoni dhe respektoni prindërit.  
Nderoni farefisnin.  
Ushqejeni të varfrin i cili është në krizë ekonomike.  
Të mirën mos e këmbeni me të keqen.  
Paturinë e jetimit dorëzojani jetimit.  
Shpenzoni nga ajo me të cilën ju kemi furnizuar.  
Flisni me drejtësi.  
Njerëzve u flisni me të mirë.  
Ndihmoheni njëri-tjetrin në mirësi dhe në devotshmëri.  
Mos e përkrahni njëri-tjetrin në mëkate dhe në armiqësi.  
Ruani amanetet (besatimet).  
Plotësojeni besën e Allahut të cilën e keni dhënë.  
Kur të peshoni në peshore, plotësojeni peshën.  
Matni drejt.  
Qëndroni me të sinqertët.  
Zbatoni marrëveshjet.

Dëshminë bëjeni për Allahun dhe dëshmoni drejt, qoftë edhe në dëm tuajin.



## **Përmbajtja:**

|                                 |    |
|---------------------------------|----|
| KAPITULLI I PARË: .....         | 4  |
| PERLA URTËSIE.....              | 4  |
| NUK KA VLERË.....               | 5  |
| EDUKATA E KUVENDIT.....         | 5  |
| RREGULLA EDUKATIVE.....         | 6  |
| TEPRIMI                         | 7  |
| SHOQËRIMI                       | 7  |
| SHOQËRIMI                       | 8  |
| BISEDA                          | 8  |
| URTËSI                          | 9  |
| RREGULLA EDUKATIVE.....         | 9  |
| CILËSI E BESIMTARIT.....        | 9  |
| QETËSIA                         | 10 |
| HUMBIA E MORALIT.....           | 10 |
| LLOJET E MENDJEVE .....         | 10 |
| SUKSESI                         | 11 |
| MIRËSITË                        | 11 |
| BAZAT E ÇËSHTJEVE.....          | 12 |
| NIVELET E FESË.....             | 13 |
| KURIOZITET                      | 14 |
| MËKATI I PARË I NJERIUT .....   | 14 |
| KURIOZITET                      | 15 |
| URTËSIA E LUKMANIT.....         | 16 |
| LLOJET E FJALËVE.....           | 16 |
| KËSHILLA E BABAIT.....          | 17 |
| FJALË ME VLERË .....            | 18 |
| SHPIRTI DHE TRUPI.....          | 18 |
| BASHKËPUNIMI .....              | 19 |
| LARGOHU NGA SHTATË CILËSI ..... | 20 |

|  |    |
|--|----|
| <i>DOBI PREJ FATKEQËSIVE</i> .....                               | 21 |
| <i>KAPITULLI I DYTË:</i> .....                                   | 22 |
| <i>RAPORTI ME ALLAHUN</i> .....                                  | 22 |
| <i>JI ME ALLAHUN</i> .....                                       | 23 |
| <i>QETËSIMI I SHPIRTIT</i> .....                                 | 23 |
| <i>PËRMENDJA E ALLAHUT</i> .....                                 | 24 |
| <i>KUR TË DO ALLAHU</i> .....                                    | 24 |
| <i>RROBA E DEVOTSHMËRISË</i> .....                               | 24 |
| <i>NJËSIA MATËSE</i> .....                                       | 25 |
| <i>MBËSHTETJA NË ZOTIN</i> .....                                 | 25 |
| <i>LLOJET E PËRMENDJEVE</i> .....                                | 26 |
| <i>MOSFALËNDERIMI</i> .....                                      | 26 |
| <i>CAKTIMI</i> 26  |    |
| <i>KËRKIMFALJA</i> .....   | 27 |
| <i>LËRI ÇËSHTJET NË KOMPETENCË TË ZOTIT</i> .....                | 27 |
| <i>KAM MENDUAR!</i> .....  | 28 |
| <i>VLERA (POZITA) JOTE, VARËSISHT PREJ ANGAZHIMIT TËND</i> ..... | 29 |
| <i>KU FILLOJNË ÇËSHTJET</i> .....                                | 30 |
| <i>QAJ NË SEXHDE</i> .....                                       | 30 |
| <i>ARDHMËRIA</i> 31  |    |
| <i>ZOTI MË PËRMEND</i> .....                                     | 31 |
| <i>CILIT T'I PËRGJIGJEM</i> .....                                | 32 |
| <i>MENDIMI I KEQ PËR ALLAHUN</i> .....                           | 33 |
| <i>PARACAKTIMI</i> .....   | 33 |
| <i>KRYELARTËSIA</i> .....  | 34 |
| <i>KUR TË MBËSHTETË ZOTI</i> .....                               | 35 |
| <i>BESIMTARI I FORTË</i> .....                                   | 35 |
| <i>NDRYSHIM I LIGJEVE TË NATYRËS</i> .....                       | 36 |
| <i>LLOJET E TREGTIVE</i> .....                                   | 37 |
| <i>SHËRIMI NGA SËMUNDJA E LARGIMIT PREJ ALLAHUT</i> .....        | 38 |
| <i>ÇËSHTJA E DASHUR DHE E URRYER</i> .....                       | 39 |

|  |    |
|--|----|
| <i>LIDHJA ME ALLAHUN DHE LIDHJA ME FAREFISIN</i> ..... | 40 |
| <b>KAPITULLI TRETË:</b> .....                          | 42 |
| <b>LUTJA</b> .....                                     | 42 |
| <i>LOTI DHE LUTJA</i> .....                            | 43 |
| <i>LUTJA</i> 43  |    |
| <i>LUTJA DHE VEPRIMI</i> .....                         | 43 |
| <i>LUTJE</i> 44  |    |
| <i>LUTJA</i> 45  |    |
| <i>LUTJA KËRKON PAK FJALË</i> .....                    | 47 |
| <i>GËZOHEM KUR NUK MË PRANOHEM LUTJA</i> .....         | 47 |
| <i>PSE NUK PRANOHEM LUTJA</i> .....                    | 48 |
| <b>KAPITULLI KATËRT:</b> .....                         | 49 |
| <b>EDUKATA</b> .....                                   | 49 |
| <i>EDUKATA</i> 50                                      |    |
| <i>I VARFËRI</i> 50                                    |    |
| <i>EDUKIMI I FËMIJËS</i> .....                         | 50 |
| <i>EDUKATA PARA JOSHJES DHE MASHTRIMIT</i> .....       | 50 |
| <i>FYTYRA E NDRITUR</i> .....                          | 51 |
| <i>UDHËTIMI PA DESTINACION</i> .....                   | 51 |
| <i>PËRTACIA DHE PAAFTËSIA</i> .....                    | 51 |
| <i>LLOJET E MBETURINAVE</i> .....                      | 52 |
| <i>LLOJET E PASTËRTIVE</i> .....                       | 52 |
| <i>ME MIRËSI</i> 53                                    |    |
| <i>ÇMIMI I LARTË DHE VEPRAT ME ÇMIM TË LARTË</i> ..... | 53 |
| <i>EDUKATA E INJORANTIT</i> .....                      | 54 |
| <i>NEVOJA PËR EDUKATËN E TRUPIT</i> .....              | 54 |
| <i>SI DUHET NGRËNË DHE SI DUHET FJETUR?</i> .....      | 55 |
| <b>KAPITULLI PESTË:</b> .....                          | 57 |
| <b>FAMILJA DHE SHOQËRIA</b> .....                      | 57 |

|   |    |
|---|----|
| <i>KUR DOMINON E KEQJA</i> .....                            | 58 |
| <i>DY BABALLARË</i> .....                                   | 58 |
| <i>DËSHIROJ FËMIJË TË MIRË</i> .....                        | 59 |
| <i>PËRKUJDESI PËR SHOQËRINË</i> .....                       | 60 |
| <i>SELAMI</i> 61  |    |
| <i>NDËRTIMI I XHAMIVE</i> .....                             | 62 |
| <i>NJERIU</i> 63  |    |
| <i>TEORIA: 99–1</i> .....                                   | 64 |
| <i>KAPITULLI GJASHTË:</i> .....                             | 65 |
| <i>POZITA, PARAJA DHE DITURIA</i> .....                     | 65 |
| <i>DIJETARI DHE PARAJA</i> .....                            | 66 |
| <i>DITURIA</i> 66   |    |
| <i>DITURIA DHE PASURIA</i> .....                            | 67 |
| <i>HARAMI DHE HALLALLI</i> .....                            | 67 |
| <i>MJETET E DITURISË</i> .....                              | 68 |
| <i>PASURIA, MATERIALIZMI, FAMA DHE POZITA</i> .....         | 69 |
| <i>LLOJET E TË PASURVE</i> .....                            | 70 |
| <i>KRENARIA</i> 71  |    |
| <i>PROVIMI I PASURISË, I SHËNDETIT DHE I FËMIJËVE</i> ..... | 72 |
| <i>HIDRI</i> 73   |    |
| <i>USHQIMI HALLALL</i> .....                                | 73 |
| <i>I DITURI DHE I URTI</i> .....                            | 74 |
| <i>NUK E DI</i> 75  |    |
| <i>GRAMATICIENTI</i> .....                                  | 75 |
| <i>LLOJET E MENDIMEVE</i> .....                             | 76 |
| <i>SPROVAT E EJUBIT A.S.</i> .....                          | 77 |
| <i>DY PACIENTËT</i> .....                                   | 78 |
| <i>FRIKA NGA RIZKU</i> .....                                | 79 |
| <i>POPULLARITETI</i> .....                                  | 80 |
| <i>BLETA DHE LAVDRUESIT</i> .....                           | 80 |
| <i>ZHVESHJA E BESIMIT</i> .....                             | 81 |

|  |    |
|--|----|
| <i>FURNIZUESI DHE I FURNIZUARI</i> .....       | 81 |
| <i>SPROVAT E JUSUFIT</i> .....                 | 82 |
| <b>KAPITULLI SHTATË:</b> .....                 | 83 |
| <b>SHEJTANI</b> .....                          | 83 |
| <i>ARMA E SHEJTANIT</i> .....                  | 84 |
| <i>SHEJTANI URDHËRON PËR IMORALITET</i> .....  | 84 |
| <i>SHEJTANI</i> 85                             |    |
| <i>SHEJTANI HAJDUT</i> .....                   | 86 |
| <i>MËKATI I PARË I SHEJTANIT</i> .....         | 86 |
| <i>ANËT NGA TË CILAT SULMON SHEJTANI</i> ..... | 87 |
| <i>SULMET E SHEJTANIT</i> .....                | 88 |
| <i>SHEJTANI DHE EJUBI A.S.</i> .....           | 89 |
| <i>SHEJTANI DHE JAKUBI</i> .....               | 89 |
| <i>NAIVITETI</i> 90                            |    |
| <i>IBLISI DHE ISAU A.S.</i> .....              | 90 |
| <b>KAPITULLI:</b> .....                        | 91 |
| <b>JETA DHE VDEKJA</b> .....                   | 91 |
| <i>NDËRRIMI I ORËS DHE JETËS</i> .....         | 92 |
| <i>JETA DHE VDEKJA</i> .....                   | 92 |
| <i>KJO BOTË DHE BOTA TJETËR</i> .....          | 92 |
| <i>KJO BOTË DHE XHENETI</i> .....              | 93 |
| <i>KJO BOTË DHE BOTA TJETËR</i> .....          | 93 |
| <i>KOHA MË E MIRA E JETËS</i> .....            | 93 |
| <i>STINËT E JETËS</i> .....                    | 94 |
| <i>JETA DHE VDEKJA</i> .....                   | 94 |
| <i>FATKEQËSIA</i> 94                           |    |
| <i>KJO BOTË</i> 95                             |    |
| <i>MËSIMI DHE PROVIMI</i> .....                | 95 |
| <i>INTERESANT</i> 96                           |    |
| <i>KUSH ÇKA DËSHIRON I REALIZOHET!?</i> .....  | 96 |

|  |     |
|--|-----|
| ISLAMI NUK ËSHTË RRUGË TRANSITE .....    | 97  |
| PROCESI I VDEKJES.....                   | 97  |
| MOS VEPRO PËR EMËR.....                  | 98  |
| ËSHTË PËR T'U HABITUR.....               | 98  |
| PËR TË VDEKURIN.....                     | 98  |
| VDEKJA E PYET JETËN .....                | 99  |
| VARRI DHE PARABURGIMI .....              | 99  |
| KAPITULLI I TETË:.....                   | 100 |
| NËNA.....                                | 100 |
| NËNA        101                          |     |
| NËNA        101                          |     |
| NËNA        102                          |     |
| LUTJE PËR NËNËN.....                     | 102 |
| MOS E NGRIT ZËRIN NDAJ NËNËS .....       | 103 |
| KUJDESI NDAJ NËNËS.....                  | 103 |
| EDUKIMI        104                       |     |
| ZEMRA E NËNËS .....                      | 104 |
| CILIN FËMIJË E DO MË SË SHUMTI.....      | 105 |
| NËNA DHE CIVILIZIMI.....                 | 105 |
| KAPITULLI I NËNTË:.....                  | 106 |
| SHKËNDIJA TË PERSONAZHEVE KUR'ANORE..... | 106 |
| DEBATI        107                        |     |
| TREGIMI MË I BUKUR .....                 | 108 |
| SURETU JUSUF.....                        | 109 |
| VONIMI I REALIZIMIT TË DËSHIRËS.....     | 109 |
| PERSONAZHET E SURETU JUSUF .....         | 110 |
| SPROVAT E JUSUFIT A.S. ....              | 111 |
| JUSUFI NË BURG DHE MINISTËR.....         | 111 |
| JUSUFI        112                        |     |
| MUSAI A.S. DHE DETI.....                 | 112 |

|   |     |
|---|-----|
| <i>FIRAUNI DHE MUSAU</i> .....                                | 112 |
| <i>ZELIHAJA DHE VAJZA E SHUAJBIT</i> .....                    | 113 |
| <i>FTESA E NUHUT</i> .....                                    | 113 |
| <i>ISMAILI ME DJALIN E NUHUT</i> .....                        | 113 |
| <i>KARUNI DHE FIRAUNI</i> .....                               | 114 |
| <i>KONFIRMIMI I LAJMIT ËSHTË PROGRAM I PEJGAMBERËVE</i> ..... | 114 |
| <i>MUSAU DHE HIDRI</i> .....                                  | 115 |
| <i>MENDO POZITIVISHT</i> .....                                | 115 |
| <i>MALLKIMI PËR IBLISIN</i> .....                             | 116 |
| <i>MOSDËGJIMI I BABAIT</i> .....                              | 116 |
| <i>ARROGANCA</i>  | 116 |
| <i>KRIMINELI</i>  | 116 |
| <i>VETPËLQIMI</i>   | 117 |
| <b>KAPITULLI I DHJETË:</b> .....                              | 118 |
| <b>LAICIZMI</b> .....   | 118 |
| <i>Laicizmi</i>   | 119 |
| <i>DUNJAJA DHE FEJA</i> .....                                 | 119 |
| <i>QEVERISJA DHE FEJA</i> .....                               | 119 |
| <i>DHUNA</i>  | 120 |
| <i>E DI AI!</i>   | 121 |
| <i>NUK E DI</i>   | 122 |
| <i>TERMINOLOGJITË</i> .....                                   | 123 |
| <i>SHOPINGU ME RASTIN E ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE</i> .....  | 123 |
| <i>E PENGON</i>   | 124 |
| <i>QENTË ENDACAK</i> .....                                    | 124 |
| <i>MBLEDHJA!</i>  | 125 |
| <i>POZITA</i>   | 126 |
| <i>KLASA E RE POLITIKE</i> .....                              | 126 |
| <i>PARTIA</i>   | 126 |
| <i>RAPORTIMET E GAZETARIT</i> .....                           | 127 |
| <i>ÇKA KONSIDEROJNË PATRIOTIZËM</i> .....                     | 128 |

|   |     |
|---|-----|
| <i>DITA E MËSUESIT</i> .....  | 129 |
| <i>“HAPUR” DHE “MBYLLUR”</i> .....                                    | 130 |
| <i>SHQETËSIMI DHE QETËSIMI</i> .....                                  | 131 |
| <i>HESHTËT DHE FOLET</i> .....  | 132 |
| <i>LAJMËRIM</i>   | 133 |
| <i>FUSHATA ELEKTORALE</i> .....                                       | 133 |
| <i>SHPENZIMI I ENERGJISË</i> .....                                    | 134 |
| <i>NGUSHËLLIMI</i> .....  | 135 |
| <i>PREMTIMET PARA ZGJEDHORE MOTI PËR MUAJIN NË VIJIM</i> .....        | 136 |
| <i>APEL PËR NDIHMË</i> .....  | 137 |
| <i>8 MARS</i>   | 138 |
| <i>SHEMBULLI TIPIK I GRUAS SË MIRË</i> .....                          | 139 |
| <i>DITA E FEMRËS, JO E NËNËS</i> .....                                | 140 |
| <i>BRENGAT</i>  | 141 |
| <i>KURIOZITET</i>   | 141 |
| <i>FJALA “BEJ’Ë” NË KUPTIMIN E VOTIMIT</i> .....                      | 142 |
| <i>SI E MENDOJNË “FJALËN E LIRË” ANALISTËT E PALOGJIKSHËM</i> ...     | 144 |
| <i>O SOT, O KURRË!</i> .....  | 145 |
| <i>ORGANIZIMI BOTËROR</i> .....                                       | 146 |
| <i>CIVILIZIMI</i>   | 147 |
| <i>TERMI POLITIK</i> .....  | 147 |
| <i>SEKTET E FILLUARA NGA TË TJERËT PËR TË DEMOLUAR UNITETIN ISLAM</i> | 148 |
| <i>DIPLOMATJA BELKISË</i> .....                                       | 151 |
| <i>HOXHA MODERN</i> .....   | 152 |
| <i>PSE MENDON SE DUHET TË VOTOHESH PËR KRYETAR KOMUNAL?</i>           | 153 |
| <i>DISKRIMINIMI</i> .....   | 154 |
| <i>NDARJA E FESË NGA SHTETI</i> .....                                 | 154 |
| <i>KURIOZITET</i>   | 154 |
| <i>NGUSHËLLIMI</i> .....  | 155 |
| <i>LIDHJA E PRIZRENIT APO KUVENDI KOMBËTAR I PRIZRENIT</i> .....      | 157 |

|   |     |
|---|-----|
| ZOTËRIU DHE ROBI I POLITIKËS.....                     | 158 |
| MEDIET 159  |     |
| TERMINOLOGJITË.....                                   | 160 |
| SHKOLLA E PARË SHQIPE.....                            | 161 |
| LETËRSIA SHQIPE ME ALFABET ARAB .....                 | 161 |
| URIMI ME LULE TË PLASTIKËS .....                      | 163 |
| FETVAJA MË E NJOHUR.....                              | 164 |
| LAICISTI 164  |     |
| KAPITULLI NJËMBËDHJETË:.....                          | 165 |
| TË NDRYSHME.....                                      | 165 |
| BËN MIRË 166  |     |
| DOBIA E SË MIRËS .....                                | 167 |
| ANALIZONI FJALËT E ZOTIT.....                         | 168 |
| I DOBËTI I FORTI DHE UJI .....                        | 169 |
| LLOJET E MJEKËVE.....                                 | 170 |
| MIZA ME KAUN .....                                    | 171 |
| SELEKTIVITETI I OBLIGIMEVE.....                       | 171 |
| MOS FOL 172   |     |
| ANKIMIMI 173  |     |
| INVESTIMI I DREJTË .....                              | 173 |
| KOMBËTARË 174   |     |
| MIRË DHE KEQ.....                                     | 175 |
| APLAUDIMI 175   |     |
| MOBILIZIMI 175  |     |
| MONSTRUMI 176   |     |
| E LEHTA, E VËSHTIRË .....                             | 177 |
| LËRI ANASH FJALËT E NJERËZVE DHE VAZHDO PËRPARA ..... | 178 |
| NDËRRIMI I QËNDRIMEVE .....                           | 179 |
| GJITHÇKA 1 EURO!.....                                 | 179 |
| ÇKA E NDRIÇON ZEMRËN.....                             | 180 |
| KUSH DUHET TË FLASË DHE PËR ÇKA DUHET TË FLASË .....  | 180 |

|  |     |
|--|-----|
| TREGU DHE MEDIAT .....                           | 180 |
| FAJTORI 181                                      |     |
| TRUPI FIZIK DHE SHPIRTI I NJERIUT .....          | 182 |
| MUSAFIRI 183                                     |     |
| VEPRIMI SHKON PARALELISHT ME TË PIKSYNUARËN..... | 184 |
| TREGTIA ME NJERIUN DHE TREGTIA ME ALLAHUN .....  | 186 |
| MOS U MERR ME ÇËSHTJE DYTËSORE .....             | 187 |
| ÇKA PRITET 188                                   |     |
| KONKURSI 188                                     |     |
| MË E MIRA 189                                    |     |
| NUMRAT ARAB.....                                 | 190 |
| PROGRAMI I JETËS STABILE.....                    | 191 |